Përshkrimi i lëndës:	Lënda e Anatomisë 2 do të ofrojë studentëve njohuri mbi ndërtimin anatomik të trupit të njeriut në funksion të arritjes së njohurive të domosdoshme për ndërtimin trupor të tyre. Këto njohuri do të mundësojnë kuptimin e lokalizimit të indeve, organeve dhe sistemeve të ndryshme të organeve. Ndërtimin e detajuar anatomikë të organeve dhe sistemeve të organeve si bazë themelore e domosdoshme për kuptimin e mëtutjeshëm e më të detajuar të funksionit, ndërtimit histologjikë, ndryshimet patologjike, rëndësinë klinike, radiologjike, kirurgjike, ortopedike, etj që do të plotësohet nga lëndët e tjera.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e lëndës së Anatomisë 2 janë të ofroj studentëve njohuri nga: a) Anatomia normale (forma dhe ndërtimi i organizmit të njeriut, duke filluar nga qeliza, indet, organet dhe sistemet e organeve) b) Anatomia topografike e trupit të njeriut; ndarja e tij në zona (regjione), raportet topografike të tija me organet dhe elementet vaskulare e nervore, projektimin e tyre në sipërfaqen e trupit duke u bazuar në pikat dhe vijat orientuese të prekshme dhe ato konvencionale c) Anatomia funksionale; ndërlydhja e formës së organit dhe sistemit të organeve me funksionin,

	<p>d) Anatomia klinike; problemet më të shpeshta klinike me të cilat atakohet organi dhe organizmi në terësi si dhe rugët më të sigurta të ndërhyrjes për eliminimin e tyre</p> <p>e) Të përvetësojë emërtimet latine sipas terminologjisë anatomike (nomenklaturës anatomike 1998) që do tju mundësojë komunikimin në mënyrë efektive/adekuate me kolegët e tyre.</p>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të mësimit studenti duhet të jetë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptojnë qëllimin e studimit të anatomisë 2. Përshkruaj karakteristikat themelore anatomike 3. Kenë njohuri të përgjithshme mbi qelizat, indet dhe sistemet funksionale të organeve 4. Njohin ndarjen e Anatomisë; pjesët kryesore të trupit të njeriut, regjionet, vijat orientuese dhe pikat referente, pozicionin dhe planet/rrafshet anatomike, nomenklaturën anatomike 5. Njohin ndërtimin dhe rëndësinë e sistemeve të organeve të ndryshme, siç janë: sistemi osteomuskular, kardiovaskular, sistemi respirator, sistemi digjektiv, sistemi urinar, sistemi i organeve gjinore mashkullore dhe femerore, sistemin endokrin, 6. Kuptojnë metodën e studimit që do të përdoret dhe mënyrën se si lënda është e organizuar. 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	3	1/15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	4	1/15	60
Konsultime me mësimsdhënësin			6
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja për provimin final	2	1/15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2 teste formative 1 provim praktik 1 provim final	2 1 1	2 1 1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			175
Metodat e mësimsdhënies:	<p>Mësimi do të realizohet në formë të: ligjëratave, seminareve dhe ushtimeve praktike - të cilat mbahen në grupe të vogla, duke përdorë materiale të ndryshme, si imazhet nga atlaset, shfrytëzimit të modeleve (mulazhave) të ndryshme si dhe organeve të ruajtura në formalin.</p>		

	Prezantimi i temave/aktiviteteve nga ana e studentëve, përsëritja dhe diskutimet gjatë ushtrimeve praktike
Metodat e vlerësimit:	Me teste formative, seminare, provimi praktikë dhe provim final (me gojë dhe test).
Literatura primare:	1. Alush Gashi, Agim Vela: <i>Osteologjia</i> , 1984 3. Bajram Nuraj: <i>Sistemi nervor periferik</i> , 1998 5. Bajram NURAK, Agim Vela, Koka dhe Qafa 4. Agim Vela, Sadi Bexheti, <i>Sistemi Nervor Qendror</i>
Literatura shtesë:	5. Putz R. Pabst R: <i>Sobotta I, II</i> 6. Bertolini / Leutert: <i>Atlas i anatomisë I, II, III</i> 7. Frank H. Netter: <i>Atlas i anatomisë së njeriut</i> 8. Gray's <i>Anatomy for Student's</i>

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Ossa crani (neurocranium): os frontale, os sphenoidale, os occipitale, os parietale, Os temporale, Os ethmoidale. Viscerocranium: maxilla, os palatinum, mandibula, cocha nasalis inferior, os lacrimale, os nasale, vomer, os zygomaticum, os hyoideum
Java 2:	Cranium: <i>cavitas cranii</i> , <i>basis cranii interna</i> , <i>basis cranii externa</i> , <i>orbita</i> , <i>cavitas nasi</i> . <i>Fossa temporalis</i> , <i>fossa infratemporalis</i> , <i>fossa pterygopalatina</i> . Njëtimet e kokës: <i>art. temporomandibularis</i> . Njëtimet e kokës me qafën: <i>art. atlanto-occipitalis</i> et <i>art. atlantoaxialis</i> .
Java 3:	Muskujt e kokës dhe të qafës. Fashat e kokës dhe të qafës. Enët e gjakut të kokës dhe të qafës (<i>a. carotis communis</i> ; <i>a. carotis externa</i> , <i>a. carotis interna</i> , <i>a. subclavia</i>). Venat e sipërfaqshme dhe të thella (<i>v. jugularis externa</i> , <i>v. jugularis interna</i> , <i>sinus durae matris</i>). Enët dhe nyjet limfatike të kokës dhe të qafës.
Java 4:	Nervat e kokës dhe të qafës: Nervat e kokës (<i>nervi craniales</i>); nn. I-V Nervat e kokës (<i>nervi craniales</i>): nn. VI-X.
Java 5:	Nervat e kokës (<i>nervi craniales</i>): nn. XI-XII. <i>Plexus cervicalis</i> . <i>Pjesa parasimpatetike</i> dhe <i>simpatetike</i> e kokës dhe e qafës <i>Cavitas oris</i> ; muret dhe organet (<i>dentes</i>).
Java 6:	<i>Lingua</i> , gll. <i>oris</i> , mm. <i>palati</i> et <i>faucium</i> . <i>Pharynx</i> : forma, pozita, ndërtimi, enët e gjakut dhe nervat. <i>Spatium peripfaryngeum</i> .

Java 7:	Nasus externus, cavitas nasi et sinus paranasales. Larynx: pozita, forma, ndërtimi, enët e gjakut dhe nervat. Glandula thyroidea et gl. Parathyroideae
Java 8:	Shqisa e të parit: kokërdhoku i syruit, mbështjellësit e kokërdhokut, Përmbajtja e kokërdhokut të syrit, aparati dioptrik, organet ndihmëse.
Java 9:	Shqisa e dëgjimit dhe baraspeshës; veshi i jashtëm, veshi i mesëm Auris interna (veshi i brendshëm).
Java 10:	Testi formativ nga Koka dhe Qafa Sistemi nervor qendror; medulla spinalis (pamja e jashtme, organizimi segmentar, citoarkitektonika e lëndës së përhimë, bërthamat dhe laminat, sistematizimi i lëndës së bardhë, harqet refleksive).
Java 11:	Truncus encephali (medulla oblongata, pons, mesencephalon). Organizimi i lëndës së përhimë Truncus encephali: bërthamat e nervave kranialë, sistemi monoaminergjik, kolinergjik dhe peptidergjik i neuroneve.
Java 12:	Cerebellum (pamja e jashtme, këmbëzat e cerrebelumit, organizimi struktural i korteksit cerebelar, lidhjet aferente dhe eferente. Ventriculus quartus. Diencephalon: ventriculus tertius. Thalamus (morfologjia e jashtme, ndërtimi i brendshëm dhe sistematizimi i bërthamave. Pedunculi thalami (sistemi talamokortikal), metathalamus, epithalamus dhe subthalamus.
Java 13:	Hypothalamus (morfologjia, ndarja, bërthamat e hypothalamusit, lidhjet aferente dhe eferente (sistemi hipotalamohipofizar. Hypophysis. Telencephalon (pamja e jashtme, ndarja). Ventriculus lateralis, telencefaloni mediobazal, rhinencephalon, sistemi limbik (lobi limbik), telencefaloni lateral, ganglionet bazale të telencefalorit lateral.
Java 14:	Telencefaloni lateral: neocortex (organizimi i korteksit truror, llojet e qelizave, fushat kortikale dhe lokalizimi funksional i korteksit truror. Sistematizimi i rrugëve trurorë (rrugët asociative, komisurale dhe projektuese). Sistemi motorik, Sistemi i somatosensibilitetit të përgjithshëm, sistemi i sensibilitetit specifik.
Java 15:	Meninges. LCS. Bariera kematoencefalike. Enët e gjakut të trurit dhe të palcës kurrizore. Testi formativ nga SNQ.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Studenti gjatë semestrit duhet të jetë i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime, duhet ti përmbahet orarit të fillimit mësimor, të ketë njohuri paraprake mbi ligjëratën/ushtrimin, të jetë i sjellshëm dhe të mos pengojë mbajtjen e mësimor.

Studentët duhet të kenë të veshur mantelat e bardhë dhe rekomandohet të kenë atlasat e antomisë në dispozicion për ushtrimet praktike.

Mjetet praktike (mulazhat ose organat forma-kadaver) që përdoren gjatë orëve të mësimor duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimor.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdoren vetëm në heshtje dhe për qëllime mësimore-teorike dhe praktike; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humbë të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.

16. Histologji dhe Embriologji

Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë – Stomatologji
Titulli i lëndës:	Histologji dhe Embriologji
Niveli:	Studime themelore të integruara
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti II Semestri III
Numri i orëve në javë:	2+0+3
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Instituti B Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Dr.Fisnik Kurshumliu
Të dhënat kontaktuese:	fisnik.kurshumliu@uni-pr.edu +38349279010
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda Histologji dhe Embriologji studion strukturën indore dhe qelizore të organizmit njerëzor si dhe fazat e zhvillimit embrional të trupit, sistemeve organike dhe organeve.</p> <p>Histologjia studion llojet e indeve, ndërtimin e tyre, organizimin, strukturën dhe disa veçori kryesore të funksionit të tyre.</p> <p>Citologjia studion veçoritë morfologjike dhe funksionale të qelizës si dhe tipet qelizore të indeve të ndryshme të organizmit.</p>

	Embriologjia studion veçoritë morfologjike të trupit, sistemeve organike, organeve dhe indeve gjatë zhvillimit embrional.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e lëndës Histologji dhe Embriologji është ofrimi i njohurive mbi ndërtimin struktural të organizmit, sistemeve organike, organeve, indeve dhe qelizave. Gjithashtu, synohet të ofrohen njohuri mbi veçoritë morfologjike dhe strukturale gjatë fazave të zhvillimit embrional të organizmit të njeriut.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti duhet të jetë në gjendje të :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njeh veçoritë themelore morfologjike të qelizës - Njeh tipet e ndryshme të indeve - Njeh veçoritë morfologjike të indeve të ndryshme - Njeh ndërtimin histologjik të organeve - Të ketë njohuri mbi procesin e konceptcionit dhe fazat e ndryshme të zhvillimit embrional të organizmit, sistemeve organike dhe organeve - Të ketë njohuri mbi veçoritë histologjike të organizmit, sistemeve organike dhe organeve gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit embrional 		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1/15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	3	1/15	45
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/13	13
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/1	1
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	2/15	30
Përgatitja për provimin final	5	1/1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1/1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			125
Metodat e mësimdhënies:	<p>Ligjeratat mbahen në grupe të mëdha në sallë të ligjeratave apo online përmes Power Point, GoogleMeet dhe/ose YouTube.</p> <p>Ushtimet mbahen në grupe të vogla në sallat përkatëse të ushtimeve përmes vizatimeve në dërrasë të bardhë (<i>white board</i>) dhe demonstrimit mikroskopik apo mikroskopit virtual (<i>virtual microscope</i>)</p>		

Metodat e vlerësimit:	Seminaret 10% Vlerësimet intermediare 10% Provimi praktik 30%; Provimi përfundimtar (testi) 50%.
Literatura primare:	HISTOLOGJIA PËR STUDENTËT E STOMATOLOGJISË– Përkthim nga Prof.Dr.Ruke Shala Beqiraj dhe Prof.Dr.Remzije Belegu HISTOLOGJI ME EMBRIOLOGJI – PRAKTIKUM nga Prof.Dr.Remzije Belegu dhe Prof.Dr.Ruke Shala Beqiraj
Literatura shtesë:	Ligjeratat e përgaditura në formë elektronike në Power Point nga Prof.Dr.Ruke Shala Beqiraj dhe Prof.Dr.Remzije Belegu Ligjeratat online ne YouTube nga Prof.Ass.Dr.Fisnik Kurshumliu

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratisë
<i>Java 1:</i>	Qeliza
<i>Java 2:</i>	Indi epitelial, lidhor dhe dhjamor
<i>Java 3:</i>	Indi kërcor dhe kockor
<i>Java 4:</i>	Indi muskular dhe nervor
<i>Java 5:</i>	Gjaku dhe palca kockore
<i>Java 6:</i>	Sistemi kardiovaskular, limfatik dhe imun
<i>Java 7:</i>	Lëkura, syri dhe veshi
<i>Java 8:</i>	Sistemi digjektiv I (goja dhe strukturat përkatëse)
<i>Java 9:</i>	Sistemi digjektiv II (ezofagu dhe trakti gastrointestinal)
<i>Java 10:</i>	Sistemi digjektiv III (mëlçia, fshika e tëmthit dhe pankreasi)
<i>Java 11:</i>	Sistemi respirator dhe urinar
<i>Java 12:</i>	Sistemi endokrin
<i>Java 13:</i>	Sistemi riprodiktiv mashkullor dhe femëror
<i>Java 14:</i>	Zhvillimi embriologjik i kavitetit oral
<i>Java 15:</i>	Zhvillimi embriologjik i dhëmbit, paradonciumit, endodonciumit dhe ektodonciumit

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.
Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.
Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

17. FIZIOLOGJIA MJEKËSORE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekesise-Katedra e Fiziologjisë
Titulli i lëndës:	Fiziologjia Mjekesore
Niveli:	Studime themelore-Obligative
Statusi i lëndës:	Dysemestrare (obligative)
Viti i studimeve:	Viti i dytë - semestri i III-të dhe i IV-të
Numri i orëve në javë:	Ligjerata- 2 orë në javë dhe 2 orë ushtrime 2+0+2; 2+0+2
Kreditë ECTS:	4+4 kredi
Koha / Vendi:	Instituti i Fiziologjisë
Mësimdhënësi:	<p>Prof.asoc. Hatixhe Latifi Pupovci, hatixhe.pupovci@uni-pr.edu, Orari i konsultimeve: E henë, Ora 10⁰⁰ – 11⁰⁰</p> <p>Prof.ass. Besa Gacaferri Lumezi, besa.gacaferri@uni-pr.edu, Orari i konsultimeve: hënë, Ora 11⁰⁰ - 12⁰⁰</p> <p>Prof.ass. Violeta Lokaj Berisha, violeta.lokaj@uni-pr.edu, Orari i konsultimeve: e hënë, Ora 11⁰⁰ - 12⁰⁰</p> <p>Koordinatori i kursit: Prof.ass. Besa Gacaferri Lumezi, besa.gacaferri@uni-pr.edu, Orari i konsultimeve: hënë, Ora 11⁰⁰ - 12⁰⁰</p> <p>Asistentët: Dr. Ilir Kurtishi, asistent, PhD kandidat Dr. Driton Vela, asistent, PhD Dr. Arber Kutllovci, asistent, PhD kandidat Dr. Gazmend Maliqaj, asistent, PhD kandidat Dr. Miranda Selmonaj, asistent, PhD kandidat</p>
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Lënda do të mbahet në formë të Ligjeratave, ushtrimeve dhe seminareve

Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i lëndës Fizilogjia e njeriut është të ofroj një prezentim në detaje të funksionit të organeve dhe sistemeve të organeve të trupit të njeriut. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë mënyrë që studentët të kuptojnë funksionin e secilit organ dhe sistem të organeve, mekanizmat rregullues në trupin e njeriut dhe integrimin fiziologjik të sistemit të organeve në ruajtjen e homeostazës.
---------------------------	--

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje të sqarojnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Integrimin e sistemeve të organeve në mbajtjen e gjendjes stabile në ambientin e brendshëm 2. Rregullimin e homeostazës përmes faktorëve nervor dhe endokrin 3. Mënyrën se si sistemi kardiovaskular, sistemi limfatik, sistemi respirator, sistemi digjektiv, sistemi urinar dhe sistemi imunitar kontribuojnë në shpërndarjen e materieve dhe në ruajtjen e homeostazës 4. Mënyrën se si sistemi nervor (qëndror, periferik dhe autonom), shqisat dhe sistemi endokrin kontribuojnë në funksionet rregullatore, komunikimin integruar dhe koordinimin e përgjithshëm të trupit të njeriut 5. Mënyrën se si sistemi reprodutiv kontribuon në reproduksion, rritje dhe zhvillim të trupit të njeriut
--	--

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	2	1/30	60
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	1/30	60
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/2	2
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	2	1/2	4

Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			50
Përgatitja për provimin final	1	1/20	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			4
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			200 / 8 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	1. Ligjerata 2. Seminare 3. Punë praktike		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi në lëndën Fiziologjia e njeriut do të bëhet nga tri forma të vlerësimit: Testet preliminare, testi përfundimtar dhe provimi me gojë.		
Literatura primare:	Artan Shkoza - Fiziologjia e njeriut Guyton & Hall - Medical Physiology		
Literatura shtesë:	Litaratura shtesë: Lauralee Sherwood -. Human Physiology Vander, Sherman, Luciano - Human Physiology. The mechanisms of Body Function Silverthon - Human Physiology Stuart Ira Fox – Human Physiology		

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Hyrje në Fiziologjinë Mjekësore - Organizimi funksional i trupit të njeriut. Homeostaza. Hapësira brendaqelizore dhe hapësira jashtëqelizore. Qeliza dhe funksioni i saj.

Java 2:	Membrana qelizore. Transporti në nivel të membranës qelizore. Potenciali membranor në qetësi.
Java 3:	Indi nervor - Ndërtimi dhe vetitë e indit nervor. Potenciali i veprimit dhe potenciali i shkallëzuar në nerva.
Java 4:	Sinapsat nervore. Neurotransmiterët. Pllaka neuromuskulare.
Java 5:	Muskujt - Ndërtimi dhe vetitë e indit muskolor. Muskulatura e skeletit. Tkurrja muskulore Metabolizmi i muskujve. Muskulatura e lëmuar. Tkurrja e muskulit të lëmuar.
Java 6:	Ndijimet speciale - Shqisa e të parit. Shqisa e të dëgjuarit.
Java 7:	Shqisa e drejtëpeshimit . Shqisa e të shijuarit. Shqisa e të nuhaturit.
Java 8:	Sistemi nervor - Sistemi nervor qëndror. Truri dhe funksionet e tij.
Java 9:	Palca kurrizore. Sistemi nervor autonom.
Java 10:	Integrimi nervor. encephali/cerebri (medulla oblongata, pons, mesencephalon Cerebellum, diencephalon: ventriculus tertius. Thalamus, hypothalamus. hypophysis.
Java 11:	Gjaku – përbërja dhe funksioni i tij. Plazma e gjakut dhe elementet e figuruara të gjakut. Hematokrit dhe sedimentimi i gjakut. Eritrocitet. Hemoglobina dhe roli i saj.
Java 12:	Leukocitet. Grupet e gjakut. Hemostaza dhe koagulimi
Java 13:	Zemra - Fiziologjia e zemrës. Ndërtimi i muskulaturës së zemrës. Potenciali i aksionit te muskuli i zemrës. Automatizmi i zemrës – sistemi për krijimin dhe përcjelljen e impulseve në zemër
Java 14:	Cikli i zemrës. Tonet e zemrës. Rregullimi i punës së zemrës.
Java 15:	EKG. Analiza vektoriale e EKG

	<i>Semestri veror</i>
Java 1:	Qarkullimi - Hemodinamika. Qarkullimi sistematik. Shtypja e gjakut dhe mekanizmat për rregullimin e shtypjes së gjakut.
Java 2:	Qarkullimi mushkëror. Dinamika në nivel të kapilarëve të gjakut. Qarkullimi koronar dhe qarkullimi i gjakut nëpër organe tjera të caktuara (tru, mëlçi etj). Sistemi limfatik.
Java 3:	Sistemi respirator - Mekanika e frymëmarrjes. Ventilimi mushkror. Shkëmbimi i gazrave.
Java 4:	Transporti i gazrave. Rregullimi i frymëmarrjes. Frymëmarrja artificiale.
Java 5:	Sistemi gastrointestinal - Fiziologjia e sistemit gastrintestinal. Funkcionet motorike të traktit gastrointestinal. Tretja dhe apsorbimi në lukth.
Java 6:	Tretja dhe apsorbimi në zorrët e holla. Lëngjet e Pankreasit. Mëlqia dhe funksioni i saj.
Java 7:	Tretja dhe apsorbimi në zorrët e trasha. Refleksi i defekimit.
Java 8:	Metabolizmi i hidrateve të karbonit. Metabolizmi i yndyrnave. Metabolizmi i proteinave.
Java 9:	Metabolizmi bazal dhe faktorët që ndikojnë në të. Rregulli i marrjes së ushqimit. Rregullimi i temperaturës. Qendra e termoregullimit.
Java 10:	Sistemi urinar - Veshkët dhe funksioni i tyre. Lëngjet e organizmit. Filtrimi glomerular.
Java 11:	Aparati jukstaglomerular. Apsorbimi dhe sekretimi në tubulet e veshkëve. Mekanizmi për eliminimin e urinës së koncentruar. Refleksi i urinimit.
Java 12:	Rregullimi i osmolalitetit të lëngjeve jashtëqelizore. Balansi acido-bazik. Mekanizmat për ruajtjen e balansit acido-bazik
Java 13:	Rolet e sistemit endokrin në kontrollin e funksionimit të organizmit. Gjëndrrat endokrine. Struktura e hormoneve. Mekanizmi i veprimit të hormoneve.
Java 14:	Hormonet e hipofizës. Hormonet e tiroidesë. Hormonet e gjëndrrës paratiroide. Hormonet e gjëndrrës mbiveshkore.

Java 15:	Hormonet e pankreasit. Hormonet e gjëndrrave seksuale. Hormonet indore.
Qëllimi i pjesës praktike	Qëllimi kryesor i moduleve praktike në përgjithësi dhe secilit modul në veçanti është: <ul style="list-style-type: none"> • zhvillimi i personalitetit aktiv dhe kompetent që do të angazhohet në punën e mëtejshme gjithnjë në ndryshim • krijimi i ndjenjës së vetbesimit • kultivimi i vullnetit të lirë për pjesmarrje në eksperiment • nxitja e gadishmërisë për nxënje dhe reprodukim të diturisë
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Zgjedhja dhe përgatitja e kafshës experimental për eksperiment. Dhënja e injeksioneve
Java 2:	Fiziologjia e nervave periferikë (Praktikum)
Java 3:	Muskujt (Praktikum)
Java 4:	Elektromiografia standarde dhe e integruar (Leksioni 1)
Java 5:	Rekrutimi i njërive motorike dhe lodhja e muskujve (Leksioni 2)
Java 6:	Shqisa e të pamurit (Praktikum)
Java 7:	Shqisa e të pamurit- vazhdim + Elektrookulogrami (Leksioni 10)
Java 8:	Shqisa e të dëgjuarit dhe shqisat tjera (Praktikum)
Java 9:	EEG 1 (Leksioni 3)
Java 10:	EEG 2 (Leksioni 4)
Java 11:	Medulla spinale (Praktikum)
Java 12:	Gjaku (Praktikum)
Java 13:	Gjaku (Praktikum)
14	Gjaku (Praktikum)
15	Kolokvimi i ushtrimeve
Semestri veror	

Java	Njësia mësimore														
<i>Java 1:</i>	Zemra (Praktikum)														
<i>Java 2:</i>	Tonet e zemrës (Leksioni 17)														
<i>Java 3:</i>	EKG I & EKG II (Leksioni 5 & 6)														
<i>Java 4:</i>	Shtypja e gjakut (Leksioni 16), rrjedhja e gjakut nëpër vena (Praktikum)														
<i>Java 5:</i>	Sistemi respirator (Praktikum) Spirometria (Leksioni 8)														
<i>Java 6:</i>	Funksioni i mushkërive 1&2 (Leksioni 12 & 13)														
<i>Java 7:</i>	Sistemi gastrointestinal (Praktikum)														
<i>Java 8:</i>	Metabolizmi (Praktikum)														
<i>Java 9:</i>	Fiziologjia e aktivitetit fizik (Leksioni 15)														
<i>Java 10:</i>	Përgjigja galvanike e lëkurës (Leksioni 9)														
<i>Java 11:</i>	Sistemi urinar (Praktikum)														
<i>Java 12:</i>	Sistemi urinar (Praktikum)														
<i>Java 13:</i>	Sistemi endokrin (Praktikum)														
<i>Java 14:</i>	Sistemi endokrin (Praktikum)														
<i>Java 15:</i>	Kolokvimi i ushtrimeve														
Vlerësimi:	Vlerësimi në lëndën <u>Fiziologjia e njeriut</u> do të bëhet nga tri forma të vlerësimit: Testet preliminare, testi përfundimtar dhe provimi me gojë.														
Testet intermediare	Organizohen në fund të secilit semestër dhe përmbajnë pyetje nga materiali i shtjelluar në ligjerata. Testet preliminare do të kenë 50 pyetje të formatit të pyetjeve me shumë përgjigje, e saktë/e pasaktë dhe pyetje me plotësime. Kohëzgjatja e testit është 2 orë shkollore, ndërsa konsiderohet se studenti ka kaluar testin nëse arrin 50% të pikëve maksimale.														
Konvertimi i pikëve të testit në nota bëhet sipas kësaj table:	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Pikët (%)</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>0 – 49</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>50 – 59</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>60 – 69</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>70 – 79</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>80 – 89</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>90 – 100</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table>	Pikët (%)	Nota	0 – 49	5	50 – 59	6	60 – 69	7	70 – 79	8	80 – 89	9	90 – 100	10
Pikët (%)	Nota														
0 – 49	5														
50 – 59	6														
60 – 69	7														
70 – 79	8														
80 – 89	9														
90 – 100	10														

Rezultatet	Rezultatet e testit do të publikohen dy ditë pas mbajtjes së testit.
Testi preliminar	<p>Organizohet në afat të provimit dhe do të përdoret për të vlerësuar njohuritë nga pjesa teorike dhe njohuritë nga pjesa praktike e lëndës së Fiziologjisë. Testi do të përmbajë 50 pyetje, nga të cilat 35 pyetje do të jenë nga pjesa teorike, ndërsa 15 pyetje nga pjesa praktike e lëndës. Pyetjet do të jenë të formatit të pyetjeve me shumë përgjigje, e saktë/e pasaktë dhe pyetje me plotësime dhe pyetje të hapura. Testi do të zgjatë 2 orë shkollore. Konsiderohet se studenti ka kaluar testin nëse arrin 50% të pikëve maksimale nga pjesa teorike dhe 50% të pikëve maksimale nga pjesa praktike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konvertimi i pikëve të testit në nota bëhet sipas skemës së mësipërme. - Rezultatet e testit do të shpallen një ditë pas mbajtjes së testit. - Në ditën e njëjtë të shpalljes së rezultateve të testit, në sallën e ligjëratave do të organizohet procedura e tërheqjes së shortit për studentë, me qëllim të përcaktimit të mësimdhënësit të i/e cili/a do t'i shtrohet provimit me gojë. - Lista e studentëve pas tërheqjes së shortit do të shpallet menjëherë pas përfundimit të tij.
Provimi me gojë	<p>Provimi do të organizohet nëpër sallat e mësimtimit dhe do të jetë i hapur për të gjithë studentët e interesuar. Të gjithë mësimdhënësit do të përdorin bankën e njëjtë të pyetjeve, ndërsa me rastin e provimit studentët do të zgjedhin me short 4 pyetje nga grumbulli i pyetjeve. Vlerësimi i studentit në provimin me gojë do të bëhet me notë prej 5-10.</p> <p>Nota përfundimtare e provimit do të llogaritet ashtu që nota e testeve intermediare do të vlerësohet me 20%, nota e testit preliminar 30% dhe nota e provimit me gojë 70%.</p>
Sinqeriteti akademik	<p>Nga të gjithë studentët prezent në provim pritet që të kontribuojnë në mbajtjen e një ambienti me sinqeritet akademik. Çdo student në provim duhet ta ketë me vete indeksin. Për të marrë pjesë në provimin Fiziologjia e njeriut studentit duhet të ketë të përfuduara të gjitha provimet e vitit të parë.</p> <p>Sjelljet në vijim janë të ndaluara gjatë mbajtjes së provimit: bisedat, përdorimi i telefonave celular, çdo formë e kopjimit. Studenti i cili gjatë provimit konstatohet se kopjon do të largohet nga provimi dhe do të anulohet provimi. Të gjitha çantat, palltot dhe gjësendet tjera duhet të lihen në një vend të caktuar në hapësirat ku mbahet provimi.</p>

18. Anatomia e dhëmbëve human me morfologji

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega e Stomatologjisë
Titulli i lëndës:	Anatomia e dhëmbëve human me morfologji
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II, semestri III
Numri i orëve në javë:	2+0+3
Kreditë ECTS:	5.0
Koha / Vendi:	QKSUK
Mësimdhënësi:	Prof.Ass. Miranda Stavileci-Veliu
Të dhënat kontaktuese:	038 500 600 2211
Përshkrimi i lëndës:	Lëmi e stomatologjisë që merret me shpjegimin e morfologjisë së jashtme dhe të brendshme të dhëmbëve human. Poashtu, kjo lëmi shpjegon edhe karakteristikat embriologjike, histologjike dhe fiziologjike të dhëmbëve human dhe aparatit mbështetës të dhëmbit.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e anatomisë së dhëmbëve është thelbësore në praktikën stomatologjike. Ajo është esenciale për diagnozë, planifikim dhe trajtim të dhëmbëve. Në pjesën didaktike të kësaj lëmie, studimi i anatomisë së dhëmbit studentëve iu ofron njohuri mbi karakteristikat anatomike dhe morfologjike të dhëmbëve dhe strukturave mbështetëse të tyre. Në pjesën praktike të kësaj lënde, studenti do të mësojë aplikimin e terminologjisë stomatologjike dhe identifikimin e secilit dhëmb të përhershëm.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Njohja me të dhënat e përgjithshme për dhëmbët, odonciumin dhe periodonciumin; Njohja me veçoritë anatomike dhe morfologjike të dhëmbëve human; Njohja me karakteristikat dhe veçoritë për secilin dhëmb të përhershëm; Përshkrimi i topografisë së brendshme dhe të jashtme për secilin dhëmb.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	3	15	45
Konsultime me mësimdhënësin	1	1x10	10
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1x5	5
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1x15	15
Përgatitja për provimin final	1	1x15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1x5	5
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			125
Metoda e mësimdhënies	Mësimi do të mbahet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtimeve praktike, diskutimeve, punës në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial, ose intermedial në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Vlerësimi i parë: 30%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 25%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%</p> <p>Vijimi i rregullt 5%</p> <p>Provimi final 30%</p> <p>Total 100%</p>		
Literatura primare:			

	<ol style="list-style-type: none"> 1. Major M. Ash. DENTAL ANATOMY PHYSIOLOGY AND OCCLUSION. W.B. Saunders Company. Copyright 1993. 2. Woelfel J. Dental Anatomy. Baltimore, USA, 1997. 3. Richard W. Brand . ANATOMY OF OROFACIAL STRUCTURE. Sixth Edition Copyright © 1998 By Mosby. Elsevier Science.
Literatura shtesë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Berkowitz BKB, Holland GR, Moxham BJ. Oral Anatomy, Histology and Embriology. Mosby, St. Louis, 2002. 2. DENTAL ANTHROPOLOGY, Simon Hillson. Cambridge University Press, 1996.
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës –semestri III
<i>Java 1:</i>	Të dhënat e përgjithme nga lëmia e studimit, si dhe njoftimi me literaturën dhe syllabusin.
<i>Java 2:</i>	Tërësia anatomike dhe funksionale e aparatit mastikator; Dhëmbi, odonciumi dhe parodontiumi.
<i>Java 3:</i>	Diferencimi i dhëmbëve sipas formës dhe funksionit; harqet e dhëmbëve dhe denticioni.
<i>Java 4:</i>	Nomenklatura (emërtimi) anatomik i pjesëve të dhëmbit; emërtimi dhe shenjat anatomiko-topografike (dalluese) të dhëmbit.
<i>Java 5:</i>	Rrënja e dhëmbëve dhe variabiliteti i saj.
<i>Java 6:</i>	Karakteristikat e incizivit qendror dhe lateral të maksillës dhe mandibullës.
<i>Java 7:</i>	Vlerësimi i parë intermediar
<i>Java 8:</i>	Karakteristikat e kaninit maksillar dhe kaninit mandibullar.
<i>Java 9:</i>	Karakteristikat e paramolarëve të maksillës.
<i>Java 10:</i>	Karakteristikat e paramolarëve të mandibullës.
<i>Java 11:</i>	Karakteristikat e molarëve të maksillës.
<i>Java 12:</i>	Karakteristikat e molarëve të mandibullës.

Java 13:	Anomalitë hereditare dhe kongjenitale të dhëmbëve; Variacionet morfologjike të dhëmbëve në veçanti.
Java 14:	Antropologjia stomatologjike dhe odontografia karahasuese.
Java 15:	Vlerësimi i dytë intermediar

Hartimi i planit mësimor- mësimi praktik	
Java	Titulli për mësimin praktik -semestriIII
Java 1:	Të dhënat e përgjithshme për dhëmbët e njeriut; Shenja e këndit, harkut, rrënjës dhe inklinimi lingual i kurorës.
Java 2:	Denticioni i dhëmbëve; Vizatimi i detaleve anatomiko-morfologjike të dhëmbëve të qumështit dhe të përherëshëm.
Java 3:	Njohja e anatomisë së jashtme dhe të brendshme të dhëmbëve të sektorit interkanin në dhëmbët natyral të ekstrahuar
Java 4:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i incizivit qendror dhe lateral të maksillës në sapun.
Java 5:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i incizivit qendror dhe lateral të mandibullës në sapun.
Java 6:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i kaninit maksillar dhe mandibullar në sapun.
Java 7:	Vlerësimi i parë intermediar
Java 8:	Njohja e anatomisë së jashtme dhe të brendshme të dhëmbëve të sektorit post kanin në dhëmbët natyral të ekstrahuar.
Java 9:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i paramolarëve maksillar në sapun.
Java 10:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i paramolarëve mandibullar në sapun.

Java 11:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i molarit të parë dhe të dytë maksillar në sapun.
Java 12:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i molarit të parë dhe të dytë mandibullar në sapun.
Java 13:	Vizatimi në fletën milimetrike, si dhe modelimi i molarit të tretë maksillar dhe mandibullar në sapun.
Java 14:	Identifikimi i tipeve të kanalit në dhëmbët e prerë natyral të ekstrahuar.
Java 15:	Vlerësimi i dytë intermediar

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.

19. Protetikë Paraklinike Mobile

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Dega e Stomatologjisë
Titulli i lëndës:	Protetikë Paraklinike Mobile
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	1+0+2 (semestri i III) dhe 2+0+2 (semestri i IV)
Kreditë ECTS:	3+4
Koha / Vendi:	QKSUK
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc. Kujtim Shala Prof.Dr. Gloria Staka Prof.Ass. Teuta Pustina - Krasniqi
Të dhënat kontaktuese:	Katedra e Protetikes Prof.Asoc. Kujtim Shala, kujtim.shala@uni-pr.edu Prof. Dr. Gloria Staka, gloria.staka@uni-pr.edu Prof.Ass. Teuta Pustina -Krasniqi, teuta.pustina@uni-pr.edu

Përshkrimi i lëndës:	Ky modul ju mundëson studentëve të njoftohen me të gjitha fazat e punimit të protezave parciale pllakore, parciale të skeletuara dhe protezave totale. Studentët do të kenë mundësinë të mësojnë dhe ushtrojnë fazat e punimit të punimeve protetike mobile të cilat kryhen në laboratorin dentar.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor është që studentëve tu mundësohet përfitimi i njohurive nga pjesa laboratorike e punimit të punimeve protetike mobile si dhe ajo klinike.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të aftësohen për punimin e të gjitha fazave laboratorike të punimit të protezave parciale dhe totale.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	3	1/15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	1/30	60
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/3	3
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/2	2
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja për provimin final	1	1/30	40
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.	1	1/4	4
Total			175/ 7 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Studentët do të marrin njohurit në formë të ligjeratave teorike dhe demonstrimit praktik në ushtime .
Metodat e vlerësimit:	<p>Parakusht për dhënjen e provimit nga Protetika Mobile (paraklinikë) është dhënja e kollokfiumit nga lënda gjegjëse.</p> <p>Provimi përbëhet nga pjesa praktike dhe teorike.</p> <p>Përvetësimi i qasjes profesionale, aftësive të komunikimit dhe interaksionet tjera mes individëve dhe grupeve gjatë kollokfiumeve, provimi praktik dhe teorik me test. Kalushmëria 51% poenave në test.</p> <p>Vlerësimi i parë: 10%</p>

	Vlerësimi i dytë	10%
	Vijimi i rregullt	10%
	Provimi final	70%
	Gjithsej	100%
Literatura primare:	1.Doc Dr. Agim Islami : Protetika Stomatologjike – Paraklinika,1999 Prishtinë	
Literatura shtesë:	1.Lakshmi S. Preclinical Manual of Prosthodontics, third edition2018,Elsevier	
Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës (semestri III)	
<i>Java 1:</i>	Proteza parciale	
<i>Java 2:</i>	Llojet e padhëmbësisë parciale	
<i>Java 3:</i>	Ndarja e padhëmbësisë parciale sipas Kenedit	
<i>Java 4:</i>	Natyra e indeve që e bartin protezën parciale	
<i>Java 5:</i>	Proteza parciale pllakore - pjesa gingivale	
<i>Java 6:</i>	Proteza parciale pllakore - pjesët dentare	
<i>Java 7:</i>	Planifikimi i pjesës gingivale dhe dentare të protezës parciale pllakore	
<i>Java 8:</i>	Test 1	
<i>Java 9:</i>	Fazat e mbarimit të protezës parciale pllakore	
<i>Java 10:</i>	Riparimi dhe ribazimi i protezës parciale pllakore	
<i>Java 11:</i>	Proteza parciale e skeletuar - pjesa gingivale	
<i>Java 12:</i>	Proteza parciale e skeletuar - pjesët dentare	
<i>Java 13:</i>	Ateçmenët Kurorat e dyfishta	
<i>Java 14:</i>	Paralelometri Elementet për stabilizim Elementet për përcjellje dentare të trysnisë	
<i>Java 15:</i>	Test 2	

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës (semestri IV)
<i>Java 1:</i>	Proteza totale
<i>Java 2:</i>	Masat e nofullave pa dhëmbë
<i>Java 3:</i>	Masa funksionale
<i>Java 4:</i>	Mbarimi i shabllonave të kafshimit te proteza totale
<i>Java 5:</i>	Caktimi i raporteve ndërnofullore te proteza totale
<i>Java 6:</i>	Fiksimi i shabllonave dhe shënimi i vijave orientuese
<i>Java 7:</i>	Artikulatorët Pozitat dhe lëvizjet e nofullës së poshtme
<i>Java 8:</i>	Testi 3
<i>Java 9:</i>	Zgjedhja dhe vendosja e dhëmbëve artificialë frontalë
<i>Java 10:</i>	Zgjedhja dhe vendosja e dhëmbëve artificialë lateralë
<i>Java 11:</i>	Përgatitja e modeleve të punës, të instrumenteve dhe të materialit për vendosjen e dhëmbëve artificialë
<i>Java 12:</i>	Caktimi i pozitës së dhëmbëve frontalë në raportin eugnat të nofullave
<i>Java 13:</i>	Caktimi i pozitës së dhëmbëve anësorë në raportin eugnat të nofullave sipas kërkesave të okluzionit të balancuar
<i>Java 14:</i>	Mbrojtja gjatë punës në laboratorin dentar
<i>Java 15:</i>	Test 4

20. Materialet në Stomatologji

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Dega e Stomatologjisë		
Titulli i lëndës:	Materialet në Stomatologji		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	1+0+2 (semestri III)		
Kreditë ECTS:	3 ECTS		
Koha / Vendi:	QKSUK		
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Kujtim Shala Prof.Dr.Gloria Staka Prof.Ass.Teuta Pustina - Krasniqi Katedra e Protetikës Stomatologjike Prof.Asoc. Kujtim Shala, kujtim.shala@uni-pr.edu Prof. Dr. Gloria Staka, gloria.staka@uni-pr.edu Prof.Ass.Teuta Pustina -Krasniqi, teuta.pustina@uni-pr.edu		
Të dhënat kontaktuese:	Katedra e Protetikës Stomatologjike		
Përshkrimi i lëndës:	Ky modul ju mundëson studentëve të njoftohen me të gjitha materialet, të cilat përdoren në stomatologji. Studentët do të kenë mundësinë të mësojnë dhe ushtrorjnë aftësitë/shkathtësitë të shoqëruara me përgaditjen e materialeve të ndryshme në pjesën e ushtrimeve praktike.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor është që studentëve tu mundësohet përfitimi i njohurive nga fusha e materialeve të cilat përdoren në stomatologjinë bashkëkohore.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të aftësohen për aplikimin e njohurive teorike dhe praktike të të gjitha materialeve, të cilat përdoren në lëmitë e ndryshme të stomatologjisë.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	1 /15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	1/15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	3	3

Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik	7	1	7
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			
Projektet, prezantimet, etj.	-	-	-
Total			75/3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Studentët do të marrin njohuritë në formë të ligjeratave teorike dhe demonstrimit praktik në ushtrime .		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi do të bëhet me testet me zgjidhje të shumëfishta.		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.asoc. Agim Islami, Ass.dr. Dugagjin Sokoli: Materialet në Protetikën Stomatologjike,1998 Prishtinë. 2. Prof.Dr. Veton Hoxha. Sëmundjet e dhëmbit – paraklinike,1999 Prishtinë 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.dr. Vjekoslav Jerolimov: Osnove stomatoloskih materiala. Zagreb ,2005. 2. O’Brian,V: Dental materials and their selection, second edition, Quintessence,1997,Chicago 		

Hartimi I planit mësimor:	
Java	Titulli I Ligjëratisë
<i>Java 1:</i>	Hyrje – Materialet në Protetikën Stomatologjike
<i>Java 2:</i>	Struktura e materies dhe vetitë e materialeve
<i>Java 3:</i>	Materialet ndihmëse
<i>Java 4:</i>	Materialet për mbarimin e modeleve të punës
<i>Java 5:</i>	Materialet për modelim (dylli dentarë)
<i>Java 6:</i>	Materialet termorezistuese dhe burimet e nxehtësisë
<i>Java 7:</i>	Matalet dhe ndarja e metaleve
<i>Java 8:</i>	Materialet ndërtuese – Aliazhet për punime protetikore fikse
<i>Java 9:</i>	Aliazhet për punime protetikore mobile
<i>Java 10:</i>	Bashkimi në një tërësi i pjesëve me origjinë metalike
<i>Java 11:</i>	Shkrirja dhe derdhja e aliazheve dentare
<i>Java 12:</i>	Rezinat
<i>Java 13:</i>	Porcelani
<i>Java 14:</i>	Materialet për mbushjen e përkohshme të kaviteve
<i>Java 15:</i>	Materialet për mbushjen e përhershme të kaviteve

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.

21. DUHANPIRJA DHE SHENDETI ORAL

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Stomatologjisë		
Titulli i lëndës:	Duhanpirja dhe Shëndeti Oral		
Niveli:	Studime bazike të integruara		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti II, sem III		
Numri i orëve në javë:	1+0+1 (L+S+U)		
Kreditë ECTS:	3		
Koha / Vendi:	Sipas orarit të publikuar nga FM / Amfiteatri QKSUK		
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Fatmir DRAGIDELLA, Dr Sc		
Të dhënat kontaktuese:	Klinika e Parodontologjisë dhe Mjekësisë Orale Dega e Stomatologjisë-Fakulteti i Mjekësisë Rrethi Spitalit, p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë Tel: +383 38 512 525 lok 100; fatmir.dragidella@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Studentët do të njoftohen me bazat e shëndetit oral, rolin dhe rëndësinë e duhanpirjes në shëndetin e indeve të kavitetit oral, ndikimi i substancave toksike në strukturat e forta dhe mukozat e kavitetit oral, dhe patologjitë specifike që manifestohen te duhanpirësit.		
Qëllimet e lëndës:	Të njihen me ndikimin e duhanit në strukturat e kavitetit oral.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që të njohë ndryshimet e shkaktuara nga duhani në zgavrën e gojës.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	1/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1	1
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/15	15
Detyrë shtëpie	2		2
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			25
Përgatitja për provimin final	5	1/3	15

Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1		1
Projektet, prezantimet, etj.	1		1
Total			75/3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, Seminare,		
Metodat e vlerësimit:	Vlersimi intermediar, testi, provimi teorik		
Literatura primare:	R. Ymeri: PARODONTOLOGJIA DHE MJEKËSIA ORALE, PRISHTINË, 2004		
Literatura shtesë:	1. J. Lindhe et al: Clinical Periodontology and Implant Dentistry, Wiley Blackwell, 2015 2. NEWMAN, TAKEI, KLOKKEVOLD, CARRANZA. Newman and Carranza's Clinical Periodontology THIRTEENTH EDITION Elsevier, 2019		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratës		
<i>Java 1:</i>	L.1 Njohuritë bazike mbi ndërtimin e kavitetit oral		
<i>Java 2:</i>	L.2 Njohuritë bazike mbi duhanin dhe përbërjen e tij		
<i>Java 3:</i>	L.3 Veprimi i duhanit në organizmin e njeriut		
<i>Java 4:</i>	L.4 Modifikimi i florës bakteriale orale te duhanpirja		
<i>Java 5:</i>	L.5 Duhampirja dhe shërimi i plagës orale		
<i>Java 6:</i>	L.6 Duhampirja dhe sëmundjet e gingivës		
<i>Java 7:</i>	L.7 Duhampirja dhe sëmundjet e gjuhës		
<i>Java 8:</i>	L.8 Duhampirja dhe sëmundjet e gjëndrrave pështymore		
<i>Java 9:</i>	L.9 Duhampirja dhe sëmundjet parodontale		
<i>Java 10:</i>	L.10 Duhampirja dhe kariesi		
<i>Java 11:</i>	L.11 Duhampirja dhe sëmundjet mapinje të kavitetit oral		
<i>Java 12:</i>	L.12 Duhampirja dhe implantologjia		
<i>Java 13:</i>	L.13 Stomatitis nicotinic		
<i>Java 14:</i>	L.14 Duhampirja dhe foetor ex ore		
<i>Java 15:</i>	L.15 Ndërprerja e pirjes së duhanit		

S.1 Gjatë semestrit të VI studenti do të punoi seminarin, nën mbikqyrje të profesorit, nga lista e publikuar e temave seminarike për student. Gjatë këtij semestri studenti dhe së bashku me mentorin praktikoj veprimin e duhanit në kavitetin oral.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes që aplikohen janë konform statutit të UP-së.



22. Parandalimi i Infeksioneve në Stomatologji

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega e Stomatologjisë
Titulli i lëndës:	Parandalimi i Infeksioneve në Stomatologji
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i II (dytë), semestri i III (tretë)
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Amfiteatri i QKSUK, dhe sallat e seminareve
Mësimdhënësi:	Prof.Assoc. Dr. Resmije Ademi-Abdyli Prof.Ass.Dr. Zana Agani Prof.Ass.Dr. Jehona Ahmedi
Të dhënat kontaktuese:	resmije.ademi@uni-pr.edu zana.agani@uni-pr.edu jehona.ahmedi@uni-pr.edu Konsultimet: E premte ora 11:00 – 12:00
Përshkrimi i lëndës	<p>Programi mësimor i lëndës realizohet gjatë semestrit të III (tretë) . Ky program përfshinë njësi mësimore mbi principet e prevencës dhe kontrollës së infeksionit dhe masat standarde të ndërmarra gjatë punës rutinore stomatologjike si dhe masat e veçanta të bazuara në sëmundjet transmise gjatë punës me pacientë të grupit të rrezikut. Në kuadër të programit mësimor rëndësi e veçantë i kushtohet prevencës ekspozuese dhe dhe menaxhimit postekspozues respektivisht masave mbrojtëse të personelit shëndetësor për shkak të kontaktit të tyre me material infektiv si pështyma dhe gjaku gjatë punës me pacient të sëmurë dhe mundësisë së përcjelljes së sëmundjeve gjegjëse transmetuese me ajër apo me gjak e që mund të parandalohen me vaksinim.</p> <p>Kapitull i veçantë u dedikohet principeve të prevencës dhe kontrollës së infeksionit të cilat kanë për qëllim që gjatë intervenimeve stomatologjike të mbrohen të dy palët, respektivisht pacientët dhe punëtorët shëndetësorë duke aplikuar principet e pastrimit, dezinfektimit, sterilizimit të instrumenteve stomatologjike , të ambientit dhe mjeteve të punës si dhe menaxhimi të mbeturinave që mbesin pas intervenimeve stomatologjike.</p>

Qëllimet e lëndës:	Që të informojë studentin mbi sëmundjet infektive që mund të transmetohen me kontakt me gjak apo pështymë nga pacienti në mjek dhe anasjelltas gjatë punës rutinore në stomatologji. Poashtu të informojë studentin për masat parandaluese që duhet ndërmarrur para dhe pas ekspozimit ndaj infeksionit. Llojet dhe procedurat e dezinfektimit dhe sterilizimit si dhe mënyrën e trajtimit të materialit të mbetur pas intervenimeve stomatologjike
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët duhet të aftësohen për : <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhjen e mjeteve për mbrojtje personale dhe të pacientit gjatë punës rutinore stomatologjike, - punë me pacient të grupit të rrezikuar- me sëmundje ngjitëse - ndërmarrjen e masave parandaluese gjatë punës me kontakt me pështymë dhe gjak si dhe masat kontrolluese pas incidenteve shpuesë - zgjedhjen adekuate të mjeteve dezinfektuese dhe kryerjen e procedurave të ndryshme të sterilizimit - për organizimin e hapësirës së ordinancës sipas rregullave të kontrollës së infeksionit dhe trajtimit të mbetjeve infektive pas trajtimit stomatologjik

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	1	5	5
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/4(çdo muaji gjatë semestrit)	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	10	10
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	25	25
Përgatitja për provimin final	1	1/15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1		1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 /3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia bëhet me ligjerata dhe seminare. Poashtu studentëve u demonstron në mënyrë praktike procedura e dezinfektimit dhe sterilizimit dhe si bëhet trajtimi i materialit të kontaminuar		

Metodat e vlerësimit:	Provimi final mbahet me shkrim në formë testi - kalueshmëria sigurohet me 51% të pikëve totale. Vlerësimi i pare 5% (1- 5%) Aktiviteti –Seminaret 5% (1-5%) Vijimi i ligjeratave dhe ushtrimeve 5% (1-5%) Provimi final 85% Gjithsej 100 pikë maksimum
Literatura primare:	1. Cottone's Practical Infection Control in Dentistry, 3rd Edition. 2. 2010 Lippincott Williams & Wilkins, Molinari J. A. and Harte J.A 3. N.N. Damani. 2004. Priručnik o postupcima kontrole infekcija. Merkur A.B.D. Zagreb3. 4. Ligjeratat e Profesorit të lëndës
Literatura shtesë:	1. Odabrana poglavlja iz: Priručnik o postupcima kontrole infekcija. N.N. Damani. 2004. Merkur A.B.D. Zagreb

Hartimi i planit mësimor teorik për semestrin e III (tretë):

Java	Titulli I ligjeratave që do të zhvillohen
Java 1:	L.1.Njohja me planprogramin e lëndës - Parandalimi dhe kontrolla e infeksioneve në stomatologji. Historia e zhvillimit të principeve të prevencës dhe kontrollit të infeksionit në stomatologji, Burimi i infeksionit, shkaqet, dhe mënyra e transmetimit të infeksioneve të kryqëzuara principet e prevencës dhe kontrollës së infeksioneve në mjekësi dhe stomatologji
Java 2:	L.2.Masat standarde për prevencë dhe kontrollë të infeksionit gjatë punës në stomatologji: - higjiena e duarëve - përdorimi i mjeteve mbrojtëse personale (dorëzat, maska, syzat dhe rrobat mbrojtëse) - trajtimi i sipërfaqeve të mjedisit punues - trajtimi i dhe transportimi i instrumenteve dhe paisjeve dentare që mund të kontaminohen
Përshkrimi i lëndës:	<p>Sëmundjet Infektive Lenda permban pjesen e pergjithshme dhe speciale.</p> <p>PJESA E PERGJITHSHME(I) Janë përfshirë:Parimet e pergjithshme të sëmundjeve infektive, aspekti epidemiologjik ,patogjeneza e sëmundjes, karakteristikat klinike të sëmundjeve ngjitëse, parimet bazë të diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve ngjitëse .</p> <p>PJESA SPECIALE(II)- Infeksioni i shkaktuar nga streptokoku,stafilokoku ,anginat , hepatitet virale ,infeksionet e traktit respirator ,infeksionet e traktit gastrointestinal ,infeksionet e SNQ-së dhe sëmundjet e shkaktuara me prione ,semundjet ekzantematike ,sindromi septik dhe gjendjet febrile me etiologji të pa qartë .spiroketozat (Sifilisi, leptospiroza, Lyme borelioza,) zoonozat, infeksionet e traktit urinar sëmundjet parazitare dhe tropikale , infeksionet anaerobe,HIV infeksioni dhe AIDS</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Pergaditja e studentit me njohuri bazike mbi infeksionin dhe semundjet infektive,marrjen korrekte të anamnezës egzaminimi objektiv.Marrja e njohurive mbi mënyren e përhapjes se infeksionit ,patogjenezen e sëmundjeve infektive ,aspektet kliniko-laboratorike.Arritja e shkathtësive ne diagnostikim e sakt dhe trajtimin bashkëkohor te sëmundje ngjitëse.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> •Marrja korrekte e anamnezës me theks të veçantë në sëmundje ngjitëse-anamnezën sipas sistemve dhe anketen epidemiologjike •Ezaminimi e traktit respirator ne veqanti kavitetin oral, tonsillet dhe gjendrrat limfatike • Aplikimi i shenjave meningjeale dhe egzaminimi i pergjithshen neurologjik • Interpretimi i rezultateteve të analizës citologjike ,biokimike, dhe mikrobiologjike të lengjeve trupore •Egzaminimi klinik i pacientit me ikter, palpimi i melcisë dhe shpretkes

	<ul style="list-style-type: none"> •Egzaminimi i pacienteve me semundje infektive te traktit gastrointestinal,marrja korrekte e te dhenave anamnestike dhe vlerësimi I shkallës se dehidrimit. •Egzaminimi i pacienteve me semundje egzantematike dhe diferencimi i efloreshencave tipike. •Egzaminimi i pacienteve me semundje te lekures dhe te mukozave dhe arritja e aftesive per diferencimin e natyres infektive te semundjes. •Marrja e njohurive mbi manifestimet klinike të etheve hemoragjike , dallimi i shenjave te para të diatezes hemoragjike • Egzaminimi i pacientveve ne gjendje septike dhe studenti të jetë në gjenjdje të dalloj diasa aspekte kryesore te gjendjes septike • Egzaminimi i pacientit me AIDS ne veqanti me karakteristikat anamnestike dhe klinike te sëmundjes,
--	---

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	2	2
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	2	2
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			20
Përgatitja për provimin final	1	5	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			1

Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 / 3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Ligjeratë e drejteperdrejtë		
Metodat e vlerësimit:	Provim praktik dhe provimi me gojë		
Literatura primare:	<i>Listoni literaturën e domosdoshme.</i> Semundjet Infektive, Tirane, E. Altari me bashkepuntorë, 2009		
Literatura shtesë:	<i>Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë.</i> Leksionet, Katedra e Semundjeve Ngjitese-Prishtinë		
Hartimi I planit mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		
<i>Java 1:</i>	Infektologjia e përgjithshme		
<i>Java 2:</i>	Diagnostikimi dhe trajtimi i sëmundjeve ngjitëse		
<i>Java 3:</i>	Infeksioni i shkaktuar nga streptokoku, stafilokoku dhe anginat		
<i>Java 4:</i>	Hepatitet virale		
<i>Java 5:</i>	Infeksionet e traktit respirator		
<i>Java 6:</i>	Infeksionet e traktit gastrointestinal		
<i>Java 7:</i>	Infeksionet e SNQ-se dhe sëmundjet e shkaktuara me prione		
<i>Java 8:</i>	Semundjet ekzantematike		
<i>Java 9:</i>	Sindromi septik dhe gjendjet febrile me etiologji te pa qartë		
<i>Java 10:</i>	Spiroketozat (Sifilis, leptospiroza, Lyme borelioza)		
<i>Java 11:</i>	Zoonozat		
<i>Java 12:</i>	Infeksionet e traktit urinar		
<i>Java 13:</i>	Semundjet parazitare dhe tropikale		

Java 14:	Infeksionet emergjente
Java 15:	HIV infeksioni dhe AIDS

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.

40. DERMATOVENEROLOGJIA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti I Mjekësisë ,Drejtimi-Stomatologjia
Titulli i lëndës:	Dermatovenerologjia
Niveli:	Studime te integruara
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I III-të,semestri I VI
Numri i orëve në javë:	1+2
Kreditë ECTS:	ECTS: 3
Koha / Vendi:	Salla në Stomatologji /KDV
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Afërdita Daka;
Të dhënat kontaktuese:	038500600-42-58 / 41-22
Përshkrimi i lëndës:	<p>Dermatologjia është shkencë mjekësore që merret me sëmundjet e lëkurës dhe me sëmundjet gjinore bartëse.Mjeku i praktikës së përgjithshme s'ka ditë që nuk ballafaqohet me sëmundjet e lëkurës.Ato shfaqen në çdo moshë në të dyja gjinitë,në çdo profesion,në të gjitha kushtet e jetesës.Lëkura është dritare,ku pasqyrohet gjendja e brendshme e organizmit,jo vetëm fizike,por edhe ajo shpirtërore.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> • Dermatologjia është shkencë mjekësore që merret me sëmundjet e lëkurës dhe me sëmundjet gjinore bartëse. • Stomatologu duhet të marrë njohurit elementare për sëmundjet e lëkurës. • Diagnostikimin e simptomeve te paraqitura në hapsirën e gojës e që janë të ndërlidhura me sëmundjet dermatologjike. • Të diagnostikoj dhe trajtoj sëmundjet e lëkurës me manifestim në gojë.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët gjatë vijimit të këtij moduli do të arrijnë njohurit elementare për diagnostikimin, trajtimin dhe krahasimin e lidhshmërisë së dermatozave me paraqitje në gojë dhe pjesët tjera të lëkurës.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	15 javë	15 orë
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15 javë	30 orë
Punë praktike			
Konsultime me mësimmshënës	1	5 javë	5 orë
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	12 javë	12 orë
Përgatitja për provimin final	1	12 javë	12 orë
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75/ 3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata, Seminare dhe ushtime.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p>		

	Provimi praktik: 30% Provimi final: 60% Total 100%
Literatura primare:	Prof.Dr.Simë Gjon Dobreci, DERMATOVENEROLOGJIA,botimi i katërt i plotësuar dhe i përpunuar,Prishtinë, 2009. Prof.Ass.Mybera Ferizi,SËMUNDJET E LËKURËS-Praktikum me atlasin topografik,Prishtinë, 2003. Prof.Ass.Mybera Ferizi,VENEROLOGJIA-Sëmundjet seksualisht të transmetueshme, Prishtinë , 2004.
Literatura shtesë:	Prof.Asoc.Afërdita Krasniqi Daka,Atlasi i dermatovenerologjisë,Prishtinë,2006 Prof.Ass.Mybera Ferizi ,Puçrrat e rinisë-Aknet vulgare,Prishtinë , 2006 Prof.Ass.Mybera Ferizi ,Dielli dhe rrezitja,Prishtinë, 2006
Hartimi I planit mesimor:	
Java	Titulli I Ligjerates
<i>Java 1:</i>	Anatomija dhe fiziologjia e lëkurës dhe e mukozave. Parimet diagnostike të sëmundjeve të lëkurës.
<i>Java 2:</i>	Mënyrat diagnostike ndihmëse.
<i>Java 3:</i>	Dermatoterapia.
<i>Java 4:</i>	Dermatozoonozat.Dermatomikozat.
<i>Java 5:</i>	Dermatozat bakteriale.Tuberkulozi i lëkurës.Dermatozat virusale.
<i>Java 6:</i>	Dermatozat alergjike dhe ekzematose. Egzantemat dhe enantemat
<i>Java 7:</i>	Kolagjenozat e lëkurës.Dermatozat buloze

Java 8:	Dermatozat eritematoze. Dermatozat eritemo- Skuamoze.
Java 9:	Dermatozat seborroike. Dermatozat e fëmijërisë.
Java 10:	Sëmundjet e flokëve. Sëmundjet e thonjëve.
Java 11:	Çrregullimet e djersitjes. Diskeratozat
Java 12:	Nishanet, tumoret dhe kancerete lëkurës
Java 13:	Vazopatitë dhe vaskulitet. Hipovitaminozat dhe lëkura. Dispigmentimet e lëkurës. Dermatozat nga shkaqet fizike.
Java 14:	Lëkura dhe sëmundjet e brendshme. Dermatozat trashëguese dhe distrofitë. Sëmundjet e gojës
Java 15:	Sëmundjet gjinore bartëse.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimin, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks.

41. NEUROPSIKIATRI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Katedra e Neuropsikiatrisë
Titulli i lëndës:	Neuropsikiatri
Niveli:	Studime te integruara
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III semestri VI
Numri i orëve në javë:	1+2
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	Kliniken e Neurologjisë dhe psikiatrisë
Mësimdhënësi:	Prof. Zylfije Hundozi
Të dhënat kontaktuese:	Prof. Zylfije Hundozi, + 38138 500 600 28 30, termini i caktuar për bisedë me studentë - Klinika e Neurologjisë, e martë 10.00-10.45
Përshkrimi i lëndës:	Neurologjia është shkencë e cila merret me studimin e çrregullimeve të sistemit nervor qendror, dhe periferik,

	<p>sëmundjeve të muskujve dhe sëmundjeve të pllakës neuromuskulore. Është shkencë lidhëse ndërmjet shkencave bazike dhe përvojës praktike dhe e cila bazohet në hulumtimin e shkaktarit të sëmundjes (etiologjisë), mekanizmit të zhvillimit (patogenezës), mekanizmave patofizilogjikë, simptomatologjinë dhe shenjat klinike, metodat diagnostikuse bashkëkohore dhe mënyrat e trajtimit bashkëkohor të sëmundjeve neurologjik.</p> <p>Psikiatri është shkencë e cila merret me sëmundjet shpirtërore. Bazohet në intervisten psikiatrike, metodat psikologjike si dhe metodat tjera diagnostikuese për të dalluar jonormalen nga normalja.</p>
<p>Qëllimet e lëndës:</p>	<p>Qëllimet e këtij moduli janë të zhvillojë njohuri të punës së strukturave normale dhe funksionimit të sistemit nervor (SNQ dhe SNP), pllakës neuromuskulore, muskujve dhe duke u bazuar në këto njohuri të kuptohen sa më mirë çrregullimet neurologjike, ndikimin e këtyre çrregullimeve në të sjellur, shëndet dhe sëmundje, gjithmonë duke pasur parasysh se shumica e sëmundjeve neurologjike shkaktojnë dëmtime të rënda trupore me pasoja të rënda edhe për psikologjinë e njeriut. Të mësohen principet bazike të diagnostikimit, terapisë në sëmundjet e ndryshme neurologjike .</p> <p>Moduli do të përbehet nga ligjeratat, ushtrimet, puna në grupe, vlerësime të mbështetur nga të lexuarit direkt dhe referenca me objektiva të detajizuara Qëllimet e këtij moduli janë të zhvillojë njohuri të reja të të kuptuarit të çrregullimeve psikiatrike duke u bazuar në specifikat e kësaj lëmie dhe duke i njohur studentët me etiologjinë, simptomatologjinë, diagnozën diferenciale dhe mënyrën bashkëkohore të diagnostikimit psikiatrik të bazuar në punë ekipore. Informata mbi trajtimin bashkëkohor të këtyre sëmundjeve si dhe rehabilitimi dhe socializimi në komunitet.</p> <p>Moduli do të përbehet nga ligjeratat, ushtrime, puna në grupe, vlerësime të mbështetur nga të lexuarit direkt dhe referencat.</p>
<p>Rezultatet e pritshme të nxënies:</p>	<p>Të dijë rolin e strukturave të caktuara të SNQ në raport me funksionin</p> <p>Të kuptojë fiziologjinë dhe mekanizmat patofizilogjikë të strukturave të caktuara të SNQ</p> <p>Të kuptojë etiologjinë, patogenezën, simptomatologjinë, klinikën e sëmundjeve neurologjike</p>

	<p>Të dijë metodat diagnostikuese në neurologji</p> <p>Të ketë shkathtësi për intervisten në psikiatri dhe të krijojnë raport të mirë komunikimi me pacientë</p> <p>Të dallojë normalen nga jonormalja në psikiatri</p> <p>Të kuptojë mekanizmat psikopatologjikë të sëmundjeve psikiatrike</p> <p>Të kuptojë simptomatologjinë, klinikën e sëmundjeve psikiatrike</p> <p>Të dijë metodat e trajtimit bashkëhor të sëmundjeve psikiatrike</p>
--	---

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	2	2
Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	1	12	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	-	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75/ ECTS

Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi do të mbahet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtimeve praktike klinike. Marrja e anemnezës, fitimi shkathësive për ekzaminimin neurologjik, njohja me metodat diagnostike, marrja njohurive se si duhet të vendoset një diagnozë neurologjike. Fitimi i shkathtësive për intervisten në psikiatri të dallojë normalen nga jonormalja në psikiatri duke krijuar marrëdhënie të mirë me pacientin dhe duke</p>
--------------------------------	--

	<p>e fituar besimin e tij si parakusht për të kuptuar vështirësitë e pacientit në mënyrë që të vendoset diagnoza e saktë dhe të ndërmerren hapat për trajtim të mirë.</p> <p>Shfrytëzimi i internetit (web faqeve të ndryshme).</p>				
Metodat e vlerësimit:	<p>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pjesa teorike</th> <th>Pjesa praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>40%</td> <td>60%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Vlerësim do të bëhet me testim , pastaj studnti I nënshtrohet prvimit dhe praktik dhe vlerësim përfundimtar bëhet me provim teorik..</i></p>	Pjesa teorike	Pjesa praktike	40%	60%
Pjesa teorike	Pjesa praktike				
40%	60%				
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. J.Cambier, M.Masson, H.Dehen, Neurologjia,Tiranë 2. B.Radojicic, Klinicka Neurologija, Beograd-Zagreb 3.Ulvi Vehbiu, Psikiatria,Tiranë,1999 4. D.Kecmanoviq ,Psikiatria 				
Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1.Grenberg D,Amionoff M,Simon R, Clinical Neurology,New York,2001 				
Hartimi i planit i mësimit:					
Java	Ligjerata që do të zhvillohet				
Java 1:	Hyrje në neurologji. Diagnostika neurologjike. NQ dhe NP.Tonusi muskolor.Reflekset.				
Java 2:	Sindromet sensitive. Fiziologjia e dhimbjes. Kokëdhimbjet. Neuralgjitë. Sindromat klinike të çrregullimit të nervave kranialë				
Java 3:	Çrregullimet e vetëdijes. Komat. Tumoret e trurit dhe palcës kurrizore				
Java 4:	Epilepsitë. Çrregullimet e gjumit.				

Java 5:	Çrregullimet demielinizuese
Java 6:	Sëmundjet cerebrovaskulare
Java 7:	Sëmundjet e sistemit ekstrapiramidal dhe çrregullimet e koordinimit
Java 8:	Sëmundjet neuromuskulare
Java 9:	Psikologjia klinike, psikopatologjia. Qëndrimi ndaj të sëmurëve psikiatrikë.Dokumentimi
Java 10:	Normalja dhe patologjika në psikiatri .Diagnostikimi i sëmundjeve psikike
Java 11:	Psikozat endogjene. Demencat
Java 12:	Gjendjet paranoide .Gjendjet kufitare
Java 13:	Çrregullimet neurotike. Çrregullimet e personalitetit. Keqpërdorimi i substancave
Java 14:	Sindromat klinike të çrregullimit të koordinimit dhe dëmtimit të funksioneve vestibulare
Java 15:	Psikaitria forenzike.Suicidi. Trajtimi emergjent në psikiatri. Terapia e çrregullimeve mendore

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së. Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyjë në kolokvium /test plotësues/. Provimi praktik është kusht për hyrje në provim përfundimtar Studenti nuk pranohet në provim pa indeks.Kërkohe mbajtja e qetësisë në mësim,çkyçja e telefonave celular,hyrja në sallë me kohë.

42. RADIOLOGJIA STOMATOLOGJIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Katedra e radiologjisë- Stomatologji
Titulli i lëndës:	Radiologjia stomatologjike
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i III-të, semestri i VI-të;
Numri i orëve në javë:	1+0+2
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	Prof Asoc.Dr Serbeze Kabashi Mucaj, dita e marte ora 9:00-10:00 QKUK Klinika e Radiologjise

	Prof Ass.Dr Kreshnike Dedushi, dita e enjte ora 9:00-10:00 QKUK Klinika e Radiologjisë		
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Dr Serbeze Kabashi-Muçaj, Prof.Ass.Dr.Kreshnike Dedushi Hoti		
Të dhënat kontaktuese:	tel. +383/48 257 554; serbeze.kabashi@uni-pr.edu tel +383/45101015: kreshnike.dedushi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Në rrjedhën e studimeve të stomatologjisë, si e domosdoshme paraqitet nevoja e njohjes së RADIOLOGJISË STOMATOLOGJIKE . Prandaj është e nevojshme që studenti të marrë njohuritë elementare mbi Radiologjinë Stomatologjike, si pjesë me interes për njohjen e imazheve karakteristike radiologjike të sëmundjeve në stomatologji, lokalizimin e tyre, formën, madhësinë dhe në bazë të tyre të përcaktoj ndryshimet patologjike.		
Qëllimet e lëndës:	<p>Është që studenti ynë të fiton shkathtësi në lëndën e cekur, të njoh metodat e ekzaminimit të sistemeve të organeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të diferencoj imazhin normal radiologjik anatomik nga ai patologjik. • Të njoh shenjat karakteristike radiologjike të sëmundjeve, lokalizimin e tyre, formën, madhësinë dhe në bazë të tyre të përcaktoj ndryshimet patologjike. • Të mëson bazat e mbrojtjes nga rrezet jonizuese si problem parësor në shëndetësi. • Këto baza duhet të i njoh të dalluara ato të personelit dhe ato të pacientit duke e fokusuar edhe ambientin. • Më këtë nënkuptojnë njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë që do t'i fiton studenti pas përfundimit të suksesshëm të këtij kursi-moduli. <p>Të aftësohet mbi njohuritë në interpretimin e radiografive digjitale TK dhe RM.</p>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • - Të njeh bazat e përfundimit të imazhit radiologjik në film dhe ekran dhe të interpretoj në mënyrë anatomike imazhin radiologjik dhe patologjik. • Të njeh llojet imazherike për ekzaminimin e dhëmbëve, nofullave dhe të sistemeve, të organeve, shenjat radiologjike karakteristike të sëmundjeve në stomatologji. <p>Të njeh strukturat anatomike si dhe metodat e përdorura për ekzaminim.</p>		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej

Ligjëratat	1	15 javë	15 orë
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15 javë	30 orë
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	1	1 ore ne jave	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	2	2	2
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja për provimin final	1	7	7
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 (3 ECTS)
Metodat e mësimdhënies:	Njohuritë nga fusha e Radiologjisë Stomatologjike do të përfitohen, përmes: Ligjëratave, ushtrimeve, seminareve, diskutimeve, punë në grupe sipas sistemeve.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i studentit do të bëhet përmes: vlerësimit të pjesës seminarike, testit me shkrim dhe provimit teorik. Një nga mënyrat e vlerësimit mund të jetë:</p> <p>Vlerësimi i parë 2% (vlerësimi 1-5 pikë) Vlerësimi i dytë 3% (vlerësimi 1-5 pikë) Vijimi i rregulltë 5 % (vlerësimi 1-5 pikë) Puna seminarike 10% <u>Provimi final</u> 80 % Gjithsejt 100% (100 pikë maksimum)</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Mbi 51%, student kalon</p> <p>51-60% - Nota 6 61-70% - Nota 7 71- 80%- Nota 8 81-90%- Nota 9 91-100%- Nota 10</p> <p>Studentët duhet të kenë vijueshmëri prej 75% në mënyrë që ti nenshtrohen provimit perfundimtare.</p>		
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. White S.C., 2009. Oral Radiology 2. Libri Radiologji Stomatologjike E Bicaku 3. Lannuci J.M., Howerton L.J. 5th Edition, Dental Radiography 		

	<p>4. Drage N, Whaites E. Essentials of Dental Radiography and Radiology</p> <p>5. Masri R, Driscoll C. Clinical Application of Digital Dental Technology</p> <p>6. Leksionet e marura gjatë ligjeratave Leksionet e marra gjatë ligjeratave</p>
Literatura shtesë:	Çfarëdo literature tjetër që i përshtatet këtij syllabusi (Internet etj.)

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratisë
Java 1:	Njohja me lëndën - biografia e shkurtër e W.C.Röntgenit, rëndësia e Radiologjisë dhe vend i saj në mjekësi me ilustrime, dhe me metoda të ndryshme projektuese -imazherike.
Java 2:	Fizika Radiologjike - Gypi i Röntgenit, historiku i zhvillimit, përfitimi i rrezeve X, cilësitë fizike, aparatet radiologjike, përfitimi i imazhit, metodat radiologjike, mrojtja nga rrezatimi, njësitet matëse të rrezatimit, masat mbrojtëse, normat, dozimetria
Java 3:	Radioanatomia dento-alveolare – zhvillimi, morfologjia. Radioanatomia normale dentare.
Java 4:	Ndryshimet elementare radiologjike – ndryshimet elementare destruktive, konstruktive. Ndryshimet elementare në formë dhe madhësi. Metodat e ekzaminimit.
Java 5:	Radiodiagnostika në anomalitë dentare – anomali në numër, pozitë, volum, formë dhe strukturë. Anomali radikulare. Metodat e ekzaminimit.
Java 6:	Radiodiagnostika parodontare marginale dhe e kariesit dentar – i thjeshtë, i komplikuar. Metodat e diagnostikimit.
Java 7:	I – Radiodiagnostika tek nxjerrja e dhëmbëve dhe radio-imazheria e traumatologjisë maksilofaciale – anatomia dhe patofiziologjia. Metodat imazherike.
Java 8:	II – frakturat e thjeshta, frakturat e kompleksit zigomatiko-maksilar, frakturat e mandibulës, frakturat e dhëmbëve dhe e parodontit.
Java 9:	Radiodiagnostika e nekrozave kockore, infeksionet e nofullave, osteonekroza. Radiodiagnostika e osteopative specifike – tuberkuloza, aktinomokoza. Metodat imazherike.
Java 10:	Radiodiagnostika e sinuzitit maksilar odontogjen, eksplorimi i komunikimit buko-sinusal. Radiodiagnostika në patologjinë e gjëndrave salivare. Metodat e ekzaminimit.
Java 11:	I – Radioimazheria e tumorëve të masivit facial – nomen-klatura, klasifikimi, pseudotumorët, cistat dhe tumorët e mandibulës dhe maksilës. Metodat imazherike digjitale, TK dhe RM.
Java 12:	II – Radioimazheria e tumorëve malinj të masivit facial – primar dhe sekondar. Tumorët e kavitetit nazal dhe HPN.
Java 13:	Radioimazheria në patologjinë e artikulacioneve temporo-mandibulare – traumat, inflamacionet, ndryshimet degjenerative. Metodat imazherike.
Java 14:	Kontrolla dhe evaluimi i proceseve periapikale pas tretmanit. Radiodiagnostika e trupave të huaj.
Java 15:	Roli i imazherisë me TK dhe RM në radiodiagnostikën dentare dhe maksilo-faciale si dhe në implantologji.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Politika akademike dhe rregullat e mirësjellsjelljes: mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirë sjelljes si: Mbajtja e qetësisë në mësim, ç'kyçja e telefonave celular, hyrja në sall me kohë etj.

*Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimi.
Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdoren vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*

43. ENDODONCIONI PARAKLINIK

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Dega e Stomatologjisë
Titulli i lëndës:	Endodoncioni paraklinik
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	1+0+1, semestri VI
Kreditë ECTS:	3.0
Koha / Vendi:	QKSUK
Mësimdhënësi:	Prof.dr. Blerim Kamberi Prof.ass. Violeta Vula Prof.ass. Miranda Stavileci-Veliu
Të dhënat kontaktuese:	038 500 600 2211
Përshkrimi i lëndës:	Endodoncioni paraklinik është një modul që përfshin aktivitetet paraklinike për para përgatitjen e studentëve për procedurat klinike endodontike.
Qëllimet e lëndës:	Aktivitetet paraklinike përmes teorisë dhe praktikës kanë për qëllim njoftimin me anatomicën e brendshme të sistemit të kanalit të rrënjës, si dhe simulimin e kushteve klinike për realizimin e trajtimit endodontik, përmes realizimit të çasjes endodontike, përpunimit mekanik dhe kimik të kanalit, si dhe teknikave obturuese.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi studentët do të jenë të aftë të njohin karakteristikat anatomo-morfologjike të sistemit të kanalit të rrënjës së të gjithë dhëmbëve, si dhe fazat themelore të trajtimit endodontik.
--	---

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	1	15	15
Konsultime me mësimdhënësin	1	10	10
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final	1	15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75/3.0 ECTS

Metoda e mësimdhënies	Studentët do marrin njohuritë nga mësimi teorik dhe punimet praktike.
------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	Provimi përmban pjesën teorike dhe praktike
------------------------------	---

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Torabinejad M, Walton R. Endodoncia: Parimet dhe praktika, botimi 4^{rt}, 2016, Alb-Med (përkthyer nga Katedra e Sëmundjeve të dhëmbit). 2. Veton Hoxha. Sëmundjet e dhëmbit me endodoncion, pjesa e dytë. Prishtinë, 2017.
----------------------------	---

Literatura shtesë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gunnar Bergenholtz, Preben Horsted-Bindlev and Claes Reit. <i>Textbook of Endodontology</i>, second edition. Wiley-Blackwell, 2010. 2. Stephen Cohen, Kenneth M. Hargreaves and Karl Keiser <i>Pathways of the Pulp</i>, 9th edition Elsevier Mosby, St. Louis, 2006.
--------------------------	---

Hartimi i planit mësimor-semestri VI

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Përshkrimi i anatomisë së sistemit të kanalit të rrënjës
Java 2:	Fazat themelore të punës gjatë trajtimit endodontik
Java 3:	Klasifikimi i instrumenteve endodontike
Java 4:	Përpunimi biomekanik I kanalit të rrënjës së dhëmbit
Java 5:	Metodat e përpunimit të kanalit të rrënjës
Java 6:	Obturimi definitiv i kanalit të rrënjës së dhëmbit
Java 7:	Vlerësimi i parë Intermediar
Java 8:	Përpunimi i kavitetit dhe çasja endodontike te dhëmbët e sektorit interkanin të nofullës së sipërme
Java 9:	Përpunimi i kavitetit dhe çasja endodontike te paramolarët e maksillës
Java 10:	Përpunimi i kavitetit dhe çasja endodontike te molarët e maksillës
Java 11:	Përpunimi i kavitetit dhe çasja endodontike te dhëmbët e sektorit interkanin të nofullës së poshtme
Java 12:	Përpunimi i kavitetit dhe çasja endodontike te paramolarët e mandibullës
Java 13:	Përpunimi i kavitetit dhe çasja endodontike te molarët e mandibullës
Java 14:	Gabimet më të shpeshta gjatë trajtimit endodontik
Java 15:	Vlerësimi i dytë intermediary

Hartimi i planit mësimor- mësimi praktik, semestri VI

Java	Titulli
<i>Java 1:</i>	Anatomia e brendshme e sistemit të kanalit të rrënjës së dhëmbit
<i>Java 2:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te incizivi qendror i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 3:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te incizivi lateral i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 4:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te kanini i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 5:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanaleve te paramolari i parë i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 6:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te paramolari i dytë i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 7:</i>	Vlerësimi i parë intermediar
<i>Java 8:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanaleve te molari i parë i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 9:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanaleve te molari i dytë i maksillës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 10:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te incizivi qendror dhe lateral i mandibullës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 11:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te kanini i mandibullës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 12:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanalit te paramolari i parë dhe i dytë i mandibullës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 13:</i>	Çasja endodontike dhe përpunimi i kanaleve te molari i parë i mandibullës-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 14:</i>	Obturimi definitiv i kanalit-ushtrime në modelet transparente
<i>Java 15:</i>	Vlerësimi i dytë intermediar

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Politika e mirësjelljes përcaktohet në përputhje me Statutin e Universitetit

44. ÇRREGULLIMET E NYJES TEMPOROMANDIBULARE DIAGNOSTIKA DHE TERAPIA

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Stomatologjisë Katedra e Protetikes Stomatologjike		
Titulli i lëndës:	Çrregullimet e Nyjes Temporomandibulare diagnostika dhe terapia		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i III (semestri VI)		
Numri i orëve në javë:	1+1+0		
Kreditë ECTS:	3		
Koha / Vendi:	Katedra e Protetikës Stomatologjike Prof.Asoc. Kujtim Shala, kujtim.shala@uni-pr.edu Prof. Dr. Gloria Staka, gloria.staka@uni-pr.edu Prof.Ass.Teuta Pustina -Krasniqi, teuta.pustina@uni-pr.edu		
Mësimdhënësi:	Katedra e Protetikës stomatologjike		
Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë modul studentët njihen me teoritë e ndryshme të çrregullimeve temporomandibulare; me çëndrimet bashkëkohore për etiologjinë dhe epidemiologjinë e këtyre çrregullimeve si dhe me metodat e trajtimit: terapinë medikamentoze, terapinë fizikale, terapinë me splinte si dhe terapitë specifike protetike e ortodontike.</p> <p>Studentët poashtu do të njihen me metodat kompjuterike të ekzaminimit të funksionit të sistemit dhëmbë-nofull-fytyrë si dhe të bëjnë dallimin ndërmjet çrregullimeve artrogiene dhe muskulare</p>		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Më përfundimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje: të njihen me etiologjinë e çrregullimeve temporomandibulare si dhe metodat e ndryshme të trajtimit të tyre.</p> <p>Studenti duhet të përvetësojë procedurat e thjeshta të diagnostikimit të ÇTM; duhet të njohë rastet kur kemi çrregullim të raporteve ndërnofulllore, çrregullimet e kontakteve okluzale si dhe çrregullimet në NTM dhe ato muskulare.</p>		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Semestri Dimëror-			
Aktiviteti	Orë mësimore	Javë	Gjithsej

Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	2	1	2
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final			26
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2		2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75/3.0 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Bazuar në principet e edukimit për të rritur, metodat interaktive do të dominojnë, përderisa studentët aktivisht do të inkurajohen drejt një ndërlidhjeje të teorisë me praktikën. Ligjëratat, trajnimet, sesionet laboratorike në grupe të vogla, përdorimi i videove dhe ndihmave tjera audio-vizuale, si dhe studimi i specifikuar do të ndihmojnë këtë ndërlidhje.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Përvetësimi i qasjes profesionale, aftësive të komunikimit dhe interaksionet tjera mes individëve dhe grupeve gjatë praktikës – notimi: Me notë.</p> <p>Vlerësimi i parë: 10%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 10%</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi final: 70%</p> <p>Gjithsej: 100%</p>		
Literatura primare:	<p>1. Ruzhdie Qafmolla, <i>Gnatologjia, Tiranë.</i></p> <p>2. Jeffrey Okeson, <i>Management of Temporomandibular Disorders and</i></p>		

	<p><i>Occlusion, Mosby, 2012</i></p> <p>2. Daniel Perez, Contemporary Management of Temporomandibular Joint Disorders, An Issue of Oral and Maxillofacial Surgery Clinics of North America, Elsevier 2014</p> <p>3. Temporomandibular disorders, an evidence-based approach to diagnosis and Treatment. edited by Laskin D.M, Greene C.S, Hylander W.L. Quintessence Publishing Co, Inc. Chicago, 2006</p>
Literatura shtesë:	
Hartimi i planit mësimor:	
Java 1:	Etiologjia dhe epidemiologjia e çrregullimeve temporomandibulare
Java 2:	Mekanizmi i kompensimit, toleranca fiziologjike
Java 3:	Reflekset mbrojtëse neuromuskulare
Java 4:	Shenjat dhe simptomat e çrregullimeve TM
Java 5:	Parafunksionet, veset e këqia
Java 6:	Stresi dhe komponenta psikike
Java 7:	Analiza funksionale klinike
Java 8:	Metodat diagnostike imazherike (RTG, RM)
Java 9:	Analiza funksionale instrumentale (EMG, aksiografia)
Java 10:	Modalitetet terapeutike të çrregullimeve TM, terapia initiale, preliminare, reverzibile, splintet
Java 11:	Kokëdhembjet, ÇTM dhe terapia medikamentoze
Java 12:	Terapia fizikale
Java 13:	Terapia ireverzibile me gërryerje selektive dhe reokluzion
Java 14:	Terapia ortodontike
Java 15:	Terapia kirurgjikale
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<p>Studentët janë të obliguar të mësimin teorik dhe praktik në përputhje me rregulloret e lëshuara nga Universiteti i Prishtinës dhe rregullorja për studime themelore e Fakultetit të Mjekësisë. Studentët duhet t'i përmbahen edhe rregullave tjera si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë. • T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike; • Të sillen mire si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos diskredituar Universitetin. 	

Të respektojnë të gjitha rregullat e vendosura nga njësia akademike ku organizohet mësimi

45. KIRURGJI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Stomatologji
Titulli i lëndës:	Kirurgji
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV, semestri VII
Numri i orëve në javë:	1 +2
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	E Martë, 09.15h-10.50h. Amfiteatri i Stomatologjisë në Klinkën Stomatologjike
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Nexhmi Hyseni, shef i Katedrës së Kirurgjisë Prof. dr. Arsim Morina
Të dhënat kontaktuese:	Ass.dr. Astrit Hamza, sekretar i katedrës së Kirurgjisë Klinika e Kirurgjisë, Katedra e Kirurgjisë E-mail: astrit.hamza@uni-pr.edu Tel: +381385006003254
Përshkrimi i lëndës:	Kirurgjia është degë e mjekësisë e cila diagnostifikon dhe trajton lëndimet, sëmundjet kirurgjike dhe deformitetet duke bërë largim fizik, riparim apo rirregullim të organeve dhe indeve shpesh duke përfshirë prerje kirurgjike në trup. Sot njohuritë mjekësore janë vazhdimisht në ndryshim e sipër. Masa standarde të sigurisë duhet të ndiqen, por kërkimet e reja si dhe përvoja klinike zgjerojnë njohuritë tona, ndryshimet në trajtim me terapi medikamentoze dhe kirurgjike mund të bëhen të nevojshme ose të përshtatshme.
Qëllimet e lëndës:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të dëshmojë njohje të anamnezës dhe ekzaminim objektiv kirurgjik, të resepektoj rregullat themelore të sjelljes dhe punës me pacientë në klinikë, në sallën e operacionit dhe mjekimin posoperativ të pacientit. 2. Të demonstrojë njohje të parimeve dhe teknike bazike adekuate kirurgjike, në praktikën klinike, në sallën e operacionit, i ndihmuar dhe pa ndihmën e asistentit apo profesorit. 3. Të dëshmojë njohje të metodave diagnostike në Kirurgji dhe të teknikës aseptike dhe të kuptojë parimet mikrobiologjike bazë që e mbështesin ato. 4. Të dallojë procedurat kirurgjike sipas prirjes së tyre për t'iu nënshtruar infeksionit (të pastërta, potencialisht të

	kontaminuara, të kontaminuara dhe të papastërta); të kuptojë rëndësinë e këtij klasifikimi.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>5. Të jetë në gjendje të asistojë në sallën e operacionit</p> <p>1. Të njoh parimet bazë të ekzaminimit kirurgjik të pacientit. Të arrijë të zbatojë edhe metodat tjera ekzaminuese-diagnostikuese.</p> <p>2. Përshkruan faktorët etiologjikë dhe të rrezikut për shkaktimin e sëmundjeve kirurgjike.</p> <p>3. Krahason metodat ekzaminuese joinvazive dhe invazive si dhe kupton arsyeshmerinë e zbatimit të tyre varesisht nga rasti.</p> <p>4. Fiton njohuritë themelore të nozologjisë, diagnostikimit dhe të terapisë së duhur konzervatore apo kirurgjike të pacientet me sëmundje të ndryshme kirurgjike.</p> <p>5. Fiton njohuritë themelore për organogramin e punëve klinike dhe operative për një institucion shëndetësor.</p> <p>6. Merr njohuri për mbledhjen dhe deponimin elektronik të të dhënave në dosje, dhe përdorimin e metodave statistikore për hulumtime klinike dhe shkencore.</p>

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	1/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	2	1/15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			19
Përgatitja për provimin final	1	1/5	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjëratat grupore (dy grupime), puna klinike do të organizohet nëpër të gjitha Repartet-Klinikat e Kirurgjisë, si pjesë e ushtrimeve praktike, punë seminarike në grupe të vogla dhe zbatimi i metodologjisë së të nxënurit njohuri; mësimi i bazuar në problem (MBP).
--------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Studëntët do të vlerësohen për punën e tyre; me seminare, kollokiume, teste dhe provim final. Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi praktik: 40%</p> <p>Provimi final: 50%</p> <p>Total 100%</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Pjesa Teorike</th> <th>Pjesa Praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>60%</td> <td>40%</td> </tr> </tbody> </table>	Pjesa Teorike	Pjesa Praktike	60%	40%
Pjesa Teorike	Pjesa Praktike				
60%	40%				

Literatura primare:	<p>Kirurgji. Principe dhe praktika. Volumi I dhe II. Besim Elezi dhe bashk. 2009. Tiranë</p> <p>Kirurgjia, Ivan Bradic i suradnici. Medicinska Naklada, 1995, Zazgreb</p> <p>Prirucnik za ispite: Ivan Perpiq. Zagreb. 2005</p> <p>Textbook of surgery, Third Edition. Blacwell publishing, 2010.</p> <p>Principles and Practice of Surgery, sixth edition edited by O. James Gardon, 2012 UK</p>
----------------------------	--

Literatura shtesë:	Burime nga interneti www.google.com
---------------------------	---

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Kirurgjia e përgjithshme. Hyrje. Antisepsa dhe asepsa. Infeksionet ne kirurgji
Java 2:	Plagët. Lëndimet luftarake. Djegijet
Java 3:	Politrauma. Shoku. Lidhjet dhe imobilizimi
Java 4:	Semundjet kirurgjike të qafes. Kirurgjia e gjendres tiroide. Struma. Tumoret malinje te gjendres tiroide. Tumoret e qafes
Java 5:	Neurokirurgjia. Hyrje, Infeksionet ne neurokirurgji. Neurotraumatologjia
Java 6:	Frakturat e eshtrave të kafkës. Lëndimet e medullës spinale
Java 7:	Neuroonkologjia. Gjendja e dhimbjes. Neurokirurgjia spinale.

Java 8:	Gjiri. Anatomia dhe fiziologjia e gjirit. Egzaminimet diagnostike të gjirit. Anomalite e zhvilluara të gjirit.
Java 9:	Lëndimet e gjirit, pezmatimet e gjirit, cistat e gjirit. Tumoret beninje te gjirit. Karcinoma e gjirit. Karcinoma e gjirit tek meshkujt. Ginekomastia
Java 10:	Kirurgjia torakale. Malformacionet kongjenitale të kafazit të krahërorit. Tumoret e murit të kafazit të krahërorit
Java 11:	Lëndimet e toraksit me lendim te organeve torakale. Lendimet e hapura te toraksit. Trahea, Pleura, Mushkeritë. Malformacionet kongjenitale te bronke dhe mushkerive.
Java 12:	Tumoret e mushkerive. Tumoret beninje te mushkerive. Karcinoma e mushkerive. Ekinokoku I mushkerive. Mediastinumi. Tumoret e mediastinomit
Java 13:	Kirurgjia kardiovaskulare. Anomalitë e lindura të zemres. Anomalite pa cianozë me rritje të qarkullimit pulmonar. Anomalite pa cianozë me qarkullim normal pulmonar. Anomalite me cianozë me zvoglim të qarkullimit pulmonar. Anomalite me cianozë me rritje të qarkullimit pulmonar
Java 14:	Sëmundjet e fituara të zemres. Anatomia e eneve të te gjakut të zemres. Semundjet e perikardit (Perikarditet)
Java 15:	Lendimet e zemres, te hapura dhe te mbyllura. Tamponada e zemres. Aorta disekante dhe Aneurizma e aortes. Ruptura e aortes

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Studentët dhe stafi akademik duhet të jenë aktivë dhe interaktivë në mes vete, konform rregullave dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Sistemit Shkollor të Bolonjës, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënje. Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Puna praktike duhet vijuar së paku 80%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks ose kartë identiteti e Studentit.

46. PEDIATRIA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekesise
Titulli i lëndës:	Pediatria
Niveli:	Bachelor/Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I katert / semestri i VII
Numri i orëve në javë:	1+2
Kreditë ECTS:	3 ECTS
Koha / Vendi:	Fakulteti i Mjekesise- Amfiteatri- Klinika e Pediatrise
Mësimdhënësi:	Prof. Assoc. Lidvana Spahiu, Prof. Ass. Naim Zeka, Prof Ass Vlora Ismaili - Jaha
Të dhënat kontaktuese:	038 500 600 3915

Përshkrimi i lëndës:	Njohuritë e studentëve me sëmundjet e fëmijëve sipas sistemeve dhe kujdesit përsosor, dytesor dhe tretesor të fëmijëve.
Qëllimet e lëndës:	Studentët të fitojnë njohuri për sëmundjet e ndryshme të fëmijëve në periudha të ndryshme të fëmijërisë. Metodën diagnostike, gjetjet laboratorike, ekzaminimet plotësuese dhe mjekimin e tyre.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të mësimin teoretik dhe praktik, studentët i nënshtrohen provimit. Studentët duhet të posedojnë njohuri të mjaftueshme për sëmundjet me të shpeshta të fëmijëve. Studentët duhet të jenë të aftë të ofrojnë shërbime të nivelit përsosor dhe të jenë vigjilent për referim të fëmijëve në nivelin dytesor dhe tretesor.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Dite/jave	Gjithsejt
Ligjëratat	1	1/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	-	-	-
Punë praktike	2	2/15	30
Konsultime me mësimdhënësin	-	-	-
Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik	-	-	-
Detyrë shtëpie	-	-	-
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja për provimin final	1	1/15	15
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	-	-	-
Projektet, prezantimet, etj.			
Total		15	75
Metodat e mesimdhënjes	Gjatë ligjëratave përdoret prezantimi me sllajde në power point, ligjëratat janë interaktive. Në pjesën praktike bëhet pranë fëmijëve të sëmurë me demonstrim, si dhe puna laboratorike.		
Metodat e vlerësimit	Vlerësimi i studentëve bëhet në përputhshmeri me pyetëtorin me të cilin studentët në fillim të vitit shkollor janë të pajisur. Vlerësimi i		

	studentit behet me ane nenshtrimit me provim vetem nje etape.
Literatura primare:	Prof Assoc. Lidvana Spahiu, Prof Ass Naim Zeka, prof Ass. Vlora Ismaili-Jaha
Literatura shtese:	
Hartimi I planit mesimor: Semestri dimeror	
Java	Titulli I ligjëratis
<i>Java 1:</i>	Rritja dhe zhvillimi
<i>Java 2:</i>	Pediatria sociale dhe mbrojtja shendetesoree nenes dhe femijes
<i>Java 3:</i>	I porsalinduri
<i>Java 4:</i>	Ushqyerja e femijes
<i>Java 5:</i>	Çrregullimet e gjendjes se ushqyeshmerise
<i>Java 6:</i>	Diarreja akute
<i>Java 7:</i>	Semundjet e traktit te frymemarrjes
<i>Java 8:</i>	Semundjet e zemres dhe eneve te gjakut
<i>Java 9:</i>	Semundjet e gjakut dhe organeve hematopoetike
<i>Java 10:</i>	Semundjet e traktit urinar
<i>Java 11:</i>	Semundjet e gjendrave endokrine
<i>Java 12:</i>	Semundjet e sistemit nervor dhe neuromuskular
<i>Java 13:</i>	Tuberkuloza
<i>Java 14:</i>	Semundjet reumatizmale dhe kolagjenozat
<i>Java 15:</i>	Helmimet te femijet
Praktika Klinike	
<i>Java 1:</i>	Anamneza dhe ekzaminimi objektiv
<i>Java 2:</i>	Rritja dhe zhvillimi
<i>Java 3:</i>	I porsalinduri
<i>Java 4:</i>	Ushqyerja e femijes
<i>Java 5:</i>	Çrregullimet e gjendjes se ushqyeshmerise
<i>Java 6:</i>	Diarreja akute
<i>Java 7:</i>	Semundjet e traktit te frymemarrjes
<i>Java 8:</i>	Semundjet e zemres dhe eneve te gjakut
<i>Java 9:</i>	Semundjet e gjakut dhe organeve hematopoetike
<i>Java 10:</i>	Semundjet e traktit urinar
<i>Java 11:</i>	Semundjet e gjendrave endokrine
<i>Java 12:</i>	Semundjet e sistemit nervor dhe neuromuskular
<i>Java 13:</i>	Tuberkuloza
<i>Java 14:</i>	Semundjet reumatizmale dhe kolagjenozat
<i>Java 15:</i>	Helmimet te femijet
Politikat akademike dhe rregullat e miresjelljes	
Permbajtja e orarit mesimor si nga ana e mesimdhenesve poashtu edhe nga ana e studenteve	

47. Oftalmologji

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	FAKULETI I MJEKËSISË
Titulli i lëndës:	OFTALMOLOGJI
Niveli:	Doktor i Stomatologjisë
Statusi i lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	Stomatologji, semestri i VII-të, viti i IV-të
Numri i orëve në javë:	Ligjerata dhe ushtrime: 1+2;
Kreditë ECTS:	3 ECTS kredi
Koha / Vendi:	13.40-15.15 (të enjteve) Salla e stomatologjisë
Mësimdhënësi:	Prof.dr.Kelmend Spahiu Prof.Asoc. Gazmend Kaçaniku Prof.Asis.Naser Salihu
Të dhënat kontaktuese:	<p>Prof.dr.Kelmend Spahiu Klinika e syve Konsultimet: Të mërkureve 08.10-08.20 h Tel.lok. 038 500 600 3427 Tel. mob. 044 117587 kelmend.spahiu@hotmail.com</p> <p>Prof.Asoc.Gazmend Kaçaniku Klinika e syve Konsultimet: Të mërkureve 08.00-08.10 h Tel.lok. 038 500 600 3422 Tel.mob. 044 122324 gazmendk58@yahoo.com</p> <p>Prof.Asis.Naser Salihu Klinika e syve Konsultimet: Të mërkureve 08.30-08.40 h Tel.lok. 038 500 600 3501 Tel. mob. 044 177801 nassersalihu@gmail.com</p>
Përshkrimi i lëndës	Lënda e Oftalmologjisë i mundëson studentit të njihet me egzaminimet e syrit; të fitoj njohuri për sëmundjet e syrit

	si dhe trajtimin e tyre; të njihet me anomalitë e refraksionit, ç'rregullimet e motilitetit dhe menagjimin e tyre; të ofroj ndihmën e parë të lëndimet e syrit dhe gjendjet emergjente; të njihet me shenjat dhe simptomat në sy të shkaktuara nga sëmundjet sistemike si dhe të njihet me aplikimin e barnave për sëmundje të syrit.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me njohuritë themelore për sëmundjet e syve si dhe aftësi themelor për të ofruar ndihmë pacientëve me sëmundje të syve.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të bëjë ekzaminimin themelor të syrit, të dijë të përcaktoj mprehtësinë e të pamurit si dhe të bëjë ekzaminimin e ambliopisë. 2. Të ofroj ndihmën e parë të lëndimet e syrit dhe të sëmurët me humbje akute të të pamurit. 3. Të dijë ndikimin e sëmundjeve sistemike në sy dhe t'i dalloj shenjat dhe simptomat në sy të shkaktuara nga sëmundjet sistemike. 4. T'i dijë efektet negative të barnave të përdorura në mënyrë sistemike në sy dhe efektet sistematike të barnave të përdorura për mjekimin e sëmundjeve të syve.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin			3
Puna në terren	0	0	0
Testi, punimi seminarik	1	3	3
Detyrë shtëpie	1	3	3
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15

Përgatitja për provimin final	4		4
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2		2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 orë
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata dhe ushtrime praktike		
Metodat e vlerësimit:	Pjesa praktike (20%), testi (30%), pjesa me gojë (50%)		
Literatura primare:	Cynthia A. Bradford, Executive Editor. <u>Basic Ophthalmology</u>. For medical students and primary care residents. Seventh Edition, 1999. American Academy of Ophthalmology. P.O. Box 7424, San Francisco, CA 94120 – 7424.		
Literatura shtesë:	1. Daniel G. Vaughan, Taylor Asbury, Paul Riordan-Eva. General Ophthalmology. Fourteenth edition, 1995. Appleton & Lange medical book. Stamford, Connecticut. 2. Khaw P T, Elkington A R. ABC of EYES. Second edition, 1994. BMJ Publishing Group, BMA House, Tavistock Square, London WC1H 9JR.		
Hartimi i planit mësimor			
Java	Titulli i ligjëratës		
Java 1:	Ekzaminimi i syrit – pjesa e parë (Anatomia, Optika, Vizusi – si duhet ekzaminuar) Literatura: Cynthia A. Bradford. Basic Ophthalmology. American Academy of Ophthalmology, San Francisco. Faqe 01 – 12.		
Java 2:	Ekzaminimi i syrit – pjesa e dytë (Oftalmoloskopia, Matja e tensionit intraokular, Testimi i dallimit të ngjyrave, Ngjyrosja e kornesë me fluorescein) Literatura: Cynthia A. Bradford. Basic Ophthalmology. American Academy of Ophthalmology, San Francisco. Faqe 12 – 24.		

Java 3:	<p>Humbja akute e të pamurit – pjesa e parë</p> <p>(Si duhet interpretuar rastet: Turbullirat e medimeve optike; Sëmundjet e retinës; Sëmundjet e makullës; Okluzionet vaskulare retinale).</p> <p>Literatura: Cynthia A. Bradford. Basic Ophthalmology. American Academy of Ophthalmology, San Francisco.</p> <p>Faqe 26 – 32.</p>
Java 4:	<p>Humbja akute e të pamurit – pjesa e dytë</p> <p>(Sëmundjet e nervit optik; Ç'rregullimet e fushës vizive)</p> <p>Literatura: Cynthia A. Bradford. Basic Ophthalmology. American Academy of Ophthalmology, San Francisco.</p> <p>Faqe 32 – 37.</p>
Java 5:	<p>Humbja kronike e të pamurit – pjesa e parë</p> <p>(Objektivat. Glaukoma: Informatat themelore; Si duhet ekzaminuar dhe interpretuar rastet; Menagjimi)</p> <p>Literatura: Cynthia A. Bradford. Basic Ophthalmology. American Academy of Ophthalmology, San Francisco.</p> <p>Faqe 39 – 45.</p>
Java 6:	<p>Humbja kronike e të pamurit – pjesa e dytë</p> <p>(Katarkta; Degjenerimi i makullës; Informatat themelore; Si duhet ekzaminuar dhe interpretuar rastet; Menagjimi)</p> <p>Literatura: Cynthia A. Bradford. Basic Ophthalmology. American Academy of Ophthalmology, San Francisco.</p> <p>Faqe 45 – 57.</p>
<i>Java 14:</i>	Metodat për detektimin e kariesit
<i>Java 15:</i>	Edukimi i studentëve lidhur me promovimin e shëndetit oral, kampanjat e ndryshme lidhur me promovimin e shëndetit oral, higjienën orale dhe ushqimin e drejtë

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Mësimdhënësi cakton kriteret për vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime dhe rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.

55. HEMOSTAZA NË PRAKTIKËN STOMATOLOGJIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega e Stomatologjisë
Titulli i lëndës:	Hemostaza në praktikën stomatologjike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i IV^{te} (katërt), semestri i VII^{te} (shtatë)
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3.ECTS
Koha / Vendi:	Amfiteatri i QKSUK, sallat e seminareve në Degën e Stomatologjisë/ Fakulteti i Mjekësisë
Mësimdhënësi:	Prof.Assoc. Dr. Resmije Ademi-Abdyli Prof.Ass.Dr. Zana Agani Prof.Ass.Dr. Jehona Ahmedi
Të dhënat kontaktuese:	resmije.ademi@uni-pr.edu zana.agani@uni-pr.edu jehona.ahmedi@uni-pr.edu Konsultimet: E premtë ora 11:00 – 12:00
Përshkrimi i lëndës	Programi mësimor i lëndës realizohet në vitin e IV^{te} semestri i VII^{te} . Programi mësimor me anë të ligjeratave dhe seminareve do të ju ofrojë studentëve informata të përgjithshme në lidhje me fiziologjinë e gjakut dhe sistemin hemostatic si dhe çrregullimet më të shpeshta të hemostazës si; sëmundjet e lindura ashtu edhe çrregullimet e fituara. Rëndësi e veçantë do tu kushtohet çrregullimeve të fituara të hemostazës si pasojë e medikamenteve të përdorura. Studentët do të mësohen se si duhet të identifikohen pacientët e rrezikuar për gjakderdhje gjatë intervenimeve kirurgjiko-orale, si të bëhet planifikimi i trajtimit të tyre në kuptim të prevencës apo edhe trajtimit të gjakderdhjes eventuale me theks të veçantë në hemostazën lokale (mekanike, fizike, kimike dhe biologjike) gjë që do të demonstron edhe në fantoma
Qëllimet e lëndës:	Studentët të aftësohen për identifikimin e rasteve të rrezikuara për gjakderdhje gjatë intervenimeve stomatologjike dhe kirurgjiko-orale duke u bazuar në gjendjen lokale dhe të përgjithshme të pacientit të vlerësuar edhe me analizatë caktuar laboratorike hematologjike . që studentët të aftësohen të bëjnë prevencën e gjakderdhjeve apo në rast nevojë edhe menaxhimin e tyre me metoda të hemostazës lokale.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët duhet të aftësohen për të <ul style="list-style-type: none"> - vlerësuar mundësinë e gjakderdhjes - ndërmarrë masa për parandalimin e gjakderdhjeve - përcaktuar shkakun, vendin dhe peshën e gjakderdhjes - menaxhuar gjakderdhjen eventuale varësisht nga rasti
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)	

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjëratat	1	/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	1	5	5
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/4 (çdo muaj në semestër)	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	/15	15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	/15	15
Përgatitja për provimin final			20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1		1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 /3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia bëhet me ligjerata dhe seminare dhe power point prezentime.		
Metodat e vlerësimit:	Provimi final mbahet me shkrim në formë testi me kalueshmëri prej 51% të pikëve totale. Metodat e vlerësimit: Vlerësimi i parë: 5% (vlerësimi 1 deri 5 pikë) Seminari 5 % (vlerësimi 1 deri 5 pikë) Vijimi i rregullt 5% (vlerësimi 1 deri 5 pikë) <hr/> Provimi final 85% Gjithsej 100 pikë maksimum		
Literatura primare:	1. Oral surgery-Chapter 1- Fragiskos D Fragiskos . 2007 2. Jovan V. Perovic Hemostaza u stomatoloskoj praksi-.1994 3. Lubomir Todorovic. 2002 Oralna Hirurgija		
Literatura shtesë:	1. Ligjeratat e mësimdhënësit 2. Larry J. Peterson. Oral and Maksillofacial Surgery. Third Edition 1998		

Hartimi i planit mësimor teorik për semestrin e VII^{të}(shtatë):

Java	Titulli I ligjëratis që do të zhvillohen
Java 1:	Hemostaza në praktikën stomatologjike- njohja me planprogramin e lëndës dhe rëndësinë e lëndës në punën e përditshme stomatologjike
Java 2:	Vaskularizimi i regjionit të fytyrës dhe nofullave -anatomia e enëve të gjakut dhe sistemit limfatik të fytyrës dhe nofullave.
Java 3:	Gjaku - përbërja dhe funksioni i tij
Java 4:	Elementet e gjakut-eritrocitet, funksioni normal i tyre dhe çrregullimet
Java 5:	Elementet e gjakut-leukocitet dhe trombocitet, funksioni normal i tyre dhe çrregullimet
Java 6:	Analizat rutinore të gjakut dhe roli i tyre në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të pacientit
Java 7:	Hemostaza normale
Java 8:	Hemostaza artificiale, llojet e hemostazës (lokale dhe e përgjithshme) Hemostaza lokale - mekanike dhe fizike
Java 9:	Hemostaza artificiale biologjike dhe kimike – hemostatikët lokal dhe të përgjithshëm dhe mënyra e përdorimit të tyre
Java 10:	Gjakderdhjet në stomatologji - ndarja e gjakderdhjeve, shkaqet, tabloja klinike dhe pasojat
Java 11:	Tipet e veçanta të gjakderdhjeve në stomatologji dhe menaxhimi i tyre <i>Vlerësimi intermediar</i>
Java 12:	Sëmundjet me sindrom hemorragjik- sëmundjet me çrregullime në fazën primare të hemostazës- faza vaskulare dhe trombocitare, etiologjia dhe patogjeneza dhe manifestimi klinik i tyre në regjionin oral
Java 13:	Sëmundje me sindrom hemorragjik- çrregullimet e hemostazës sekondare - koagulopatitë, etiologjia dhe patogjeneza dhe manifestimi klinik i tyre në regjionin oral
Java 14:	Pacientët me hemofili A,B,C – gjakderdhjet gjatë intervenimeve stomatologjike, klinika dhe menaxhimi i tyre
Java 15:	Trajtimi stomatologjik dhe kirurgjiko-oral i pacientëve që marrin terapi antikoagulante - trajtimi i tyre pre dhe postoperativ.
	<i>Vlerësimi i vijueshmërisë dhe aktivitetit të studentit</i>

Hartimi i planit mësimor praktik (seminaret) për semestrin e VII^{të} (shtatë):

Java	Titulli I ushtrimeve do të zhvillohen në formë seminareve dhe demonstrimit praktik si vijon më poshtë:
Java 1:	Përsëritje e njohurive mbi gjakun, përbërjen dhe rolin e tij. Analiza rutinore – pasqyra e gjakut, marrja e gjakut dhe përgatitja e strishos periferike
Java 2:	ERITROCITET - funksioni i tyre dhe pasojat e çrregullimit të numrit apo funksionit të tyre në intervenime stomatologjike
Java 3:	Elementet e gjakut – LEUKOCITET dhe TROMBOCITET funksioni i tyre dhe pasojat e çrregullimit të numrit apo funksionit të tyre në intervenime stomatologjike
Java 4:	Ripërtëritja e njohurive mbi hemostazën normale- fazat e hemostazës
Java 5:	Hemostaza artificiale - metoda mekanike dhe fizike – demonstrim i procedurës
Java 6:	Hemostaza artificiale kimike - lokale dhe e përgjithshme Demonstrim i përgatitjes dhe aplikimit të preparateve hemostike kimike lokale
Java 7:	Hemostaza artificiale biologjike - lokale dhe e përgjithshme. Demonstrim i përgatitjes dhe aplikimit të preparateve biologjike lokale
Java 8:	Vlerësimi intermediar
Java 9:	Gjakderdhjet gjatë dhe pas nxjerrjes së dhëmbit- manifestimi klinik dhe trajtimi demonstrim
Java 10:	Tipet e veçanta të gjakderdhjeve tek intervenimet në stomatologji - mekanizmi i shfaqjes dhe menaxhimi i tyre
Java 11:	Intervenimet kirurgjiko-orale tek pacientët me hemofili- , kujdesi pre dhe postoperativ i tyre- <i>demonstrim</i>
Java 12:	Trajtimi kirurgjiko-oral i pacientëve që marrin terapi antikoagulante, kujdesi pre dhe postoperativ i tyre.
Java 13:	Analizat laboratorike - llojet dhe rëndësia e tyre në vlerësimin e gjendjes së përgjithshme të pacientit dhe çrregullimeve të hemostazës demonstrim dhe interpretim
Java 14:	Përshkrimi (receptura) e hemostatikëve lokalë dhe të përgjithshëm- <i>demonstrim</i>
Java 15:	<i>Vlerësimi i vijueshmërisë dhe aktivitetit të studentit</i>

56. KIRURGJI

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Stomatologji
Titulli i lëndës:	Kirurgji
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i IV, semestri VIII
Numri i orëve në javë:	2 +2
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha / Vendi:	E Martë, 09.15h-10.50h. Amfiteatri i Stomatologjisë në Klinkën Stomatologjike
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Nexhmi Hyseni, shef i Katedrës së Kirurgjisë Prof. dr. Arsim Morina
Të dhënat kontaktuese:	Ass.dr. Astrit Hamza, sekretar i katedrës së Kirurgjisë Klinika e Kirurgjisë, Katedra e Kirurgjisë E-mail: astrit.hamza@uni-pr.edu Tel: +381385006003254
Përshkrimi i lëndës:	Kirurgjia është degë e mjekësisë e cila diagnostifikon dhe trajton lëndimet, sëmundjet kirurgjike dhe deformitetet duke bërë largim fizik, riparim apo rirregullim të organeve dhe indeve shpesh duke përfshirë prerje kirurgjike në trup. Sot njohuritë mjekësore janë vazhdimisht në ndryshim e sipër. Masa standarde të sigurisë duhet të ndiqen, por kërkimet e reja si dhe përvoja klinike zgjerojnë njohuritë tona, ndryshimet në trajtim me terapi medikamentoze dhe kirurgjike mund të bëhen të nevojshme ose të përshtatshme.
Qëllimet e lëndës:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të dëshmojë njohje të anamnezës dhe ekzaminim objektiv kirurgjik, të resepektoj rregullat themelore të sjelljes dhe punës me pacientë në klinikë, në sallën e operacionit dhe mjekimin posoperativ të pacientit. 2. Të demonstrojë njohje të parimeve dhe teknikave bazike adekuate kirurgjike, në praktikën klinike, në sallën e operacionit, i ndihmuar dhe pa ndihmën e asistentit apo profesorit. 3. Të dëshmojë njohje të metodave diagnostike në Kirurgji dhe të teknikës aseptike dhe të kuptojë parimet mikrobiologjike bazë që e mbështesin ato. 4. Të dallojë procedurat kirurgjike sipas prirjes së tyre për t'iu nënshtruar infeksionit (të pastërta, potencialisht të

	kontaminuara, të kontaminuara dhe të papastërta); të kuptojë rëndësinë e këtij klasifikimi.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>5. Të jetë në gjendje të asistojë në sallën e operacionit</p> <p>1. Të njoh parimet bazë të ekzaminimit kirurgjik të pacientit. Të arrijë të zbatojë edhe metodat tjera ekzaminuese-diagnostikuese.</p> <p>2. Përshkruan faktorët etiologjikë dhe të rrezikut për shkaktimin e sëmundjeve kirurgjike.</p> <p>3. Krahason metodat ekzaminuese joinvazive dhe invazive si dhe kupton arsyeshmerinë e zbatimit të tyre varesisht nga rasti.</p> <p>4. Fiton njohuritë themelore të nozologjisë, diagnostikimit dhe të terapisë së duhur konzervatore apo kirurgjike të pacientet me sëmundje të ndryshme kirurgjike.</p> <p>5. Fiton njohuritë themelore për organogramin e punëve klinike dhe operative për një institucion shëndetësor.</p> <p>6. Merr njohuri për mbledhjen dhe deponimin elektronik të të dhënave në dosje, dhe përdorimin e metodave statistikore për hulumtime klinike dhe shkencore.</p>

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	1/15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	2	1/15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	¼	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja për provimin final	1	1/5	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			100

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi do të jetë i rregullt, dhe do të organizohen ligjëratat grupore (dy grupime), puna klinike do të organizohet nëpër të gjitha Repartet-Klinikat e Kirurgjisë, si pjesë e ushtrimeve praktike, punë seminarike në grupe të vogla dhe zbatimi i metodologjisë së të nxënurit njohuri; mësimi i bazuar në problem (MBP).
--------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<p>Studjntët do të vlerësohen për punën e tyre; me seminare, kollokiume, teste dhe provim final. Në vlerësim duhet të caktohet përqindja e pjesëmarrjes së secilit vlerësim parcial ose intermedier në vlerësimin definitiv. Një nga mënyrat e vlerësimit do të ishte si në vazhdim:</p> <p>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5%</p> <p>Vijimi i rregullt: 5%</p> <p>Provimi praktik: 40%</p> <p>Provimi final: 50%</p> <p>Total 100%</p> <table border="1" data-bbox="813 795 1354 915"> <thead> <tr> <th>Pjesa Teorike</th> <th>Pjesa Praktike</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>60%</td> <td>40%</td> </tr> </tbody> </table>	Pjesa Teorike	Pjesa Praktike	60%	40%
Pjesa Teorike	Pjesa Praktike				
60%	40%				
Literatura primare:	<p>Kirurgji. Principe dhe praktika. Volumi I dhe II. Besim Elezi dhe bashk. 2009. Tiranë</p> <p>Kirurgjia, Ivan Bradic i suradnici. Medicinska Naklada, 1995, Zazgreb</p> <p>Prirucnik za ispite: Ivan Perpiq. Zagreb. 2005</p> <p>Textbook of surgery, Third Edition. Blacwell publishing, 2010.</p> <p>Principles and Practice of Surgery, sixth edition edited by O. James Gardon, 2012 UK</p>				
Literatura shtesë:	Burime nga interneti www.google.com				
Hartimi i planit mësimor					
Java	Titulli i ligjëratës				
Java 1:	Sëmudjet e enëve të gjakut. Nryshimet e lindura te eneve te gjakut. Lëndimet e arterieve. Lëndimet e venave. Arteritet. Sindroma kompresive e hapjes së siperme te kafazit të krahërorit. Gangrenat.				
Java 2:	Hipertensioni renovaskular. Aneurizmat. Semudnja cerebrovaskulare. Sëmudjet e venave. Venat varikoze. Insuficienca kronike e venave- sindroma posttrombotike. Limfedema				
Java 3:	Kirurgjia abdominale. Lëndimet e abdomenit.Semudjet e ezofagut. Lëndimet e ezofagut. Tumoret e ezofagut. Karcinoma e ezofagut. Refluksi gastroezofageal dhe ezofagiti.				
Java 4:	Semudnja ulqeroze dhe komplikimet e sajë. Kirurgjia e kolecistës dhe rrugëve biliare				

Java 5:	Herniet. Ileuset (obstruksioni intestinal). Zorra e hollë Sindroma Peitz-Jeghers.
Java 6:	Zorra e trashë. Apendiciti akut dhe komplikimet. Semundjet e rektumit dhe anusit.
Java 7:	Abdomeni akut. Stomat (Ileostoma dhe kolostoma)
Java 8:	Kirurgjia e mëlçisë. Kirurgjia e pankreasit. Kirurgjia e shpretkës.
Java 9:	Traumatologjia. Frakturat dhe mjekimi i tyre. Lëndimet e ekstremiteteve të sipërme. Lëndimet e ekstremiteteve të poshtme.
Java 10:	Kirurgjia plastike dhe rekonstruktive. Transplantet lëkurore dhe lebot. Kirurgjia estetike
Java 11:	Kirurgjia e dorës. Djegijet.
Java 12:	Kirurgjia pediatrike. Anomalite më të shpeshta të fytyres dhe qafës. Kirurgjia torakale pediatrike.
Java 13:	Kirurgjia abdominale pediatrike.
Java 14:	Urologjia. Semiotika në urologji. Diagnostifikimi i sëmundjeve urologjike. Anomalite kongjenitale të veshkave
Java 15:	Infeksionet urinare. Tumoret e veshkeve. Hiperplazia beninje e prostatës dhe karcinoma e prostatës. Karcinoma e fshikës. Urinare.

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Studentët dhe stafi akademik duhet të jenë aktivë dhe interaktivë në mes vete, konform rregullave dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Sistemit Shkollor të Bolonjës, në mënyrë që të arrihen rezultate më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënje. Ligjeratat duhet të vijohen së paku 70%. Puna praktike duhet vijuar së paku 80%. Nëse studenti mungon më tepër se dy ushtrime, seminare ose nuk është aktiv gjatë mësimit, duhet të hyj në kolokvium. Mbrojtja e seminarit është kusht për hyrje në provim. Studenti nuk pranohet në provim pa indeks ose kartë identiteti e Studentit.

57. ORTODONCIA PARAKLINIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Stomatologji
Titulli i lëndës:	Ortodonci Paraklinike
Niveli:	Studime të integruara
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i 4, semstri i VIII-të
Numri i orëve në javë:	1+2;
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	Amfiteatri i QKSUK dhe salla e klinikës së Ortodoncise
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Albena Reshitaj
Të dhënat kontaktuese:	Prof. Ass. Albena Reshitaj; zyra Nr.56 dhe 58; tel: 038/500600 lokali 2230, albena.reshitaj@uni.pr.edu

Përshkrimi i lëndës:	Ortodoncia është disiplinë/degë/lami e stomatologjisë që meret me studimin dhe trajtimin e anomalive të sistemit oro-facial.
Qëllimet e lëndës:	Studentët do të aftësohen për zbulimin e cregullimevet të sistemit orofacial me theks te veçante ne klasifikimin dhe diagnostifikimin e malokluzioneve gjate ritjes dhe zhvillimit te strukturave dentoalveolare.Njekohesisht do te paisen dije per shkaktaret e anomalive ortodontike dhe mundesite e prevenimit gjegjesishte kurimit ne kohe.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. beje të dallimin e denticionit të qumështit dhe të përhershëm, 2. identifikojë ,klasifikojë malokluzionin dhe 3. diagnostikimin e tyre në bazë të analizave gnatometrike në modele studjuese.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Ligjëratat	1	1/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	2	1/15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/2	2
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/11	11
Përgatitja për provimin final	1	1/10	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1/2	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 (3 ECTS)

Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata dhe punë praktike paraklinike në grupe.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 30% Vijimi i rregullt: 5 % Provimi përfundimtar: 35%.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Markovic M. dhe bashkep.: Bazat biologjike te ortodoncise, Beograd, 1999. 2. Bishara S.: Textbook of Orthodontics, W.B. Saunders Company, 2001. 3. Proffit W.: Contemporary Orthodontics, Mosby, 2002. 4. Basha A.: Ortodoncia, Tiranë, 1995. 5. Reshitaj A. Hipodontia dhe lidhshmeria me anomalite e ndryshme dentare – Monografi. Lena, Prishtinë, 2018. 6. Bassigny F.: Doracak i ortopedisë dentofaciale. Prishtinë, 2001.
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
<i>Java 1:</i>	Hyrje – njoftim me lenden. Roli I Ortodoncise ne Stomatologji Dhëmbët e qumështit dhe të përhershëm. Njohuritë për okluzionin normal
<i>Java 2:</i>	Anomalitë ortodontike, klasifikimi Malokluzionet e dhembeve ne veçanti (pozites, numrit) Malokluzionet e dhembeve ne veçanti(formes, madhesisë, struktures)
<i>Java 3:</i>	Malokluzionet e harqeve dentale- faktoret etiologjik Dendesite dhe rallesite e harqeve dentale Cregullimet e formes dhe cregullimet e madhesis se harqeve.
<i>Java 4:</i>	Testim intermediar
<i>Java 5:</i>	Përcaktimi i raporteve anteroposteriore të dhëmbëve sipas klasifikimit të Angle.
<i>Java 6:</i>	Specifikat e masës ortodontike dhe modeleve studjuese.

	<p>Metodat e diagnostifikimit te okluzionit</p> <p>Diagnoza orientuese, anamneza (rjedha e shtatzanise – menyra e te ushqyerit- lendimet – shprehite e keqija etj).</p>
<i>Java 7:</i>	<p>Statusi i pergjithshem</p> <p>Indekset kraniofacial>Statusi lokal i hapesires orale</p> <p>Diagnoza gnatometrike</p>
<i>Java 8:</i>	<p>Analiza e harkut dental</p> <p>Analiza transversale e harkut dental</p> <p>Analiza sagjitale e harkut dental</p>
<i>Java 9:</i>	<p>Analiza ne denticionit e përzier sipas Moyers-it</p> <p>Analiza sipas Bolton-it</p> <p>Analiza vertikale e harkut te dhembeve</p>
<i>Java 10:</i>	<p>Analiza e okluzionit</p> <p>Analiza e okluzionit ne transversale, ne sagjitale, ne vertikale</p> <p>Analiza e artikulacionit</p>
<i>Java 11:</i>	<p>Rritja dhe zhvillimi normal i sistemit orofacial dhe okluzionit.</p> <p>Rritja dhe zhvillimi prenatal – hapësira e gojes.</p>
<i>Java 12:</i>	<p>Dinamika e rritjes trupore</p> <p>Rritja dhe zhvillimi i dhembeve.</p> <p>Zhvillimi i neurokraniumi</p> <p>Zhvillimi i viscerokraniumit</p>
<i>Java 13:</i>	<p>Rritja dhe zhvillimi i kompleksit maksillar</p> <p>Rritja e mandibulës dhe roli i artikulacionit TM ne ritjen e nofulles se poshtme.</p>
<i>Java 14:</i>	<p>Dinamika e ritjes se skeletit kraniofacial – periudha postnatale</p> <p>Ndryshimet topografike te fytyres gjat zhvillimit postnatal</p>
<i>Java 15:</i>	<p>Fazat e zhvillimit të okluzionit.</p> <p>Okluzioni normal i dhëmbëve të qumështit dhe të përhershëm.</p>
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.	

58. STOMATOLOGJIA PREVENTIVE

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë, Dega Stomatologji		
Titulli i lëndës:	Stomatologjia preventive		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	viti i 4, semstri i VIII-të, viti 6 sem.XII		
Numri i orëve në javë:	1+2		
Kreditë ECTS:	3+3		
Koha / Vendi:	Amfiteatri i QKSUK dhe salla e klinikës së pedodoncisë		
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Fehim Haliti,		
Të dhënat kontaktuese:	Prof. Ass. Fehim Haliti; zyra Nr.58; tel: 038/500600 lokali 2230, fehim.haliti@uni-pr.edu ;		
Përshkrimi i lëndës:	Lënda përshkruan masat preventive për mbrojtjen e shëndetit në stomatologji.		
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> •Mundësite e prevenimit të shëndetit oral te fëmijët me mosha të ndryshme •Etiologjia e sëmundjeve të gojës dhe dhëmbëve te fëmijët •Diagnostifikimi I kariesit për paraqitjen e sëmundjeve orale si dhe për rëndësinë e higjienës orale •Aplikimi i fluorideve për prevencën e kariesit •Vulosja e fisurave •Kujdesi shkollorë stomatologjik dhe aplikimi I indeksave statistikorë 		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Arritja e njohurive në Shëndetit oral te fëmijët me mosha të ndryshme</p> <p>Etiologjinë e sëmundjeve të gojës dhe dhëmbëve te fëmijët</p> <p>Aplikimin e higjienës orale</p> <p>Aplikimi e masave preventive për kariesin</p>		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	1/30	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			

Punë praktike	2	1/30	60
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/10	10
Puna në terren	1	1	1
Testi, punimi seminarik	1	1	1
Detyrë shtëpie	1	1	1
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/20	20
Përgatitja për provimin final	1	1/20	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Total			150 (6 credits)
Metodat e mësimdhënies:	Ligjerata dhe punë praktike klinike në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 30% Vijimi i rregullt: 5 % Provimi përfundimtar: 35%.		
Literatura primare:	Parandalimi i sëmundjeve Orale. Universiteti UFO, Tirane, 2006		
Literatura shtesë:	Norman OH. Primary preventive dentistry. Appleton & Lange, 1999 Rexhepi R. Stomatologjia e fëmijëve. Prishtinë, 1988		
Hartimi I planit mësimor : Semestri VIII			
Java	Titulli i ligjëratës		
<i>Java 1:</i>	Stomatologjia preventive. Hyrje. Rëndësia dhe detyrat		
<i>Java 2:</i>	Epidemiologjia e sëmundjeve të gojës dhe dhembëve të fëmijëve. Terminologjia epidemiologjike në stomatologji. Dokumentacioni mjekësor në stomatologji. Kriteret për diagnostifikimin e sëmundjeve (patologjive) orale		
<i>Java 3:</i>	mekanizmat biologjik të mbrojtjes në zgavren e gojës		

Java 4:	Semundjet e indeve te forta dentare . Etiologjia e kariesit.teorite klasike per formimin (krijimin)e kariesit(kimike-bakteriale, enzimatike, elektrofizikale-fiziko-kimike etj).
Java 5:	Kuptimi bashkohore i etiologjise se kariesit. faktoret primare ne etiologjine e e kariesit te dhembeve . Faktoret sekondare (predisponues ne paraqitjene kariesit
Java 6:	Ushqimi dhe shendeti oral . Ushqimi dhe kariesi. Ndikimi i ushqimit ne dhembet ne zhvillim. Ndikimi i ushqimit ne dhembet ne funksion
Java 7:	Mollaret e pare te perhershem. Prevenimi i kariesit. Aplikimi i fluorideve ,higjiene orale,vulosja e fisurave,vaksinimi dhe aspektet imunologjike te kariesit.
Java 8:	Fluoridet dhe shendeti oral. Historiku. Fiziologjia e fluorideve.toksiciteti i fluorideve
Java 9:	Aplikimi i fluorideve ne prevenimin e kariesit
Java 10:	Higjiene orale. Mjetet dhe teknikat per mirembajtjen e higjienes orale.
Java 11:	Diagnostifikimi i riskut per paraqitjen e patologjive orale. Diagnostifikimi i riskut per paraqitjen e kariesit. Diagnostifikimi i riskut ne paraqitjen e paradontopative. Vleresimi i riskut per paraqitjen e karcinomes orale
Java 12:	Kujdesi stomatologjik parashkollore dhe shkollore
Java 13:	Ortopedia preventive dhe interceptive. Prevenimi i patologjive tjera te zgavres se gojes(prevenimi i semundjeve te mukozes se gojes dhe prevenimi i lendimeve te gojes dhe dhembeve
Java 14:	Strategjia per ruajtjen dhe permiresimin e shendetit oral. Edukimi shendetesore
Java 15:	Programi preventiv i mbrojtjes stomatologjike(1 ore) Gjithsejt

Hartimi I planit mësimor : Semestri XII	
Java	Titulli I ligjëratës
Java 1:	Stomatologjia preventive. Hyrje. Rëndësia dhe detyrat
Java 2:	Epidemiologjia e sëmundjeve te gojes dhe dhembeve te femijet. Terminologjia epidemiologjike ne stomatologji.dokumentacioni

	mjekesore ne stomatologji. Kriteret per diagnostifikimin e semundjeve (patologjive)orale
Java 3:	mekanizmat biologjik te mbrojtjes ne zgavren e gojes
Java 4:	Semundjet e indeve te forta dentare . Etiologjia e kariesit.teorite klasike per formimin (krijimin)e kariesit(kimike-bakteriale, enzimmatike, elektrofizikale-fiziko-kimike etj).
Java 5:	Kuptimi bashkohore i etiologjise se kariesit. faktoret primare ne etiologjine e e kariesit te dhembeve . Faktoret sekondare (predisponues ne paraqitjene kariesit
Java 6:	Ushqimi dhe shendetit oral . Ushqimi dhe kariesi. Ndikimi i ushqimit ne dhembet ne zhvillim. Ndikimi i ushqimit ne dhembet ne funksion
Java 7:	Mollaret e pare te perhershem. Prevenimi i kariesit. Aplikimi i fluorideve ,higjiena orale,vulosja e fisurave,vaksinimi dhe aspektet imunologjike te kariesit.
Java 8:	Fluoridet dhe shendetit oral. Historiku. Fiziologjia e fluorideve.toksiciteti i fluorideve
Java 9:	Aplikimi i fluorideve ne prevenimin e kariesit
Java 10:	Higjiena orale. Mjetet dhe teknikat per mirembajtjen e higjienes orale.
Java 11:	Diagnostifikimi i riskut per paraqitjen e patologjive orale. Diagnostifikimi i riskut per paraqitjen e kariesit. Diagnostifikimi i riskut ne paraqitjen e paradontopative. Vleresimi i riskut per paraqitjen e karcinomes orale
Java 12:	Kujdesi stomatologjik parashkollor dhe shkollor
Java 13:	Ortopedia preventive dhe interceptive. Prevenimi i patologjive tjera te zgavres se gojes(prevenimi i semundjeve te mukozes se gojes dhe prevenimi i lendimeve te gojes dhe dhembeve
Java 14:	Strategjia per ruajtjen dhe permiresimin e shendetit oral. Edukimi shendetesore
Java 15:	Programi preventiv i mbrojtjes stomatologjike(1 ore) Gjithsejt
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</i>	

59. GNATOLOGJI

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Dega e Stomatologjisë		
Titulli i lëndës:	Gnatologjia		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	IV		
Numri i orëve në javë:	1+0+1		
Kreditë ECTS:	3 ECTS		
Koha / Vendi:	QKSUK		
Mësimdhënësi:	Katedra e Protetikës Stomatologjike Prof.Asoc. Kujtim Shala, kujtim.shala@uni-pr.edu Prof. Dr. Gloria Staka, gloria.staka@uni-pr.edu Prof.Ass.Teuta Pustina -Krasniqi, teuta.pustina@uni-pr.edu		
Të dhënat kontaktuese:	Katedra e Protetikës Stomatologjike		
Përshkrimi i lëndës	Ky modul ju mundëson studentëve të njoftohen me anatomicën dhe fiziologjinë e artikulacionit temporomandibular, duke i analizuar muskujt dhe ligamentet, e gjithashtu me principet e okluzionit dhe të artikulacionit.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor është që studentëve tu mundësohet të kuptojnë në detaje artikulacionin temporomandibular, ti kuptojnë lëvizjet themelore dhe komplekse të këtij artikulacioni, si i vetmi në kafkën e njeriut, si dhe të përfitojnë njohuri nga lëmia e okluzionit dhe artikulacionit.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të aftësohen për aplikimin e njohurive teorike dhe praktike, nga lëmia e okluzionit në denticionin natyror, duke i aplikuar këto të dhëna në punimet protetikore mobile dhe fikse.		
Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	1 /15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	1	15	15
Konsultime me mësimdhënësin	1	3	3
Puna në terren	-	-	-
Testi, punimi seminarik			
Detyrë shtëpie			

Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15										
Përgatitja për provimin final			25										
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2		2										
Projektet, prezantimet, etj.	-	-	-										
Total			75/3.0 ECTS										
Metodat e mësimdhënies:	Studentët do të marrin njohuritë në formë të ligjeratave teorike dhe demonstrimit praktik në ushtrime.												
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Përvetësimi i qasjes profesionale, aftësive të komunikimit dhe interaksionet tjera mes individëve dhe grupeve gjatë seminarit si dhe provimi teorik me test. Kalushmëria 51% poenave në test.</i></p> <table> <tr> <td><i>Vlerësimi i parë:</i></td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td><i>Vlerësimi i dytë</i></td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td><i>Vijimi i rregullt</i></td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td><i>Provimi final</i></td> <td>70%</td> </tr> <tr> <td><i>Gjithsej</i></td> <td>100%</td> </tr> </table>			<i>Vlerësimi i parë:</i>	10%	<i>Vlerësimi i dytë</i>	10%	<i>Vijimi i rregullt</i>	10%	<i>Provimi final</i>	70%	<i>Gjithsej</i>	100%
<i>Vlerësimi i parë:</i>	10%												
<i>Vlerësimi i dytë</i>	10%												
<i>Vijimi i rregullt</i>	10%												
<i>Provimi final</i>	70%												
<i>Gjithsej</i>	100%												
Literatura primare:	<p>3. Prof. Ruzhdie Qafmolla : Gnatologjia</p> <p>4. Doc Dr. Agim Islami : Protetika Stomatologjike – Paraklinika,1999 Prishtinë</p>												
Literatura shtesë:	<p>1. Occlusion Principles and Concepts. Second edition, Jose dos Santos,U.S.A.1998</p> <p>2. Osnovi Gnatologije. Darinka Stanisic- Sinobad, Beograd 2001.</p> <p>3. Science and Practice of occlusion, Charles Mc Neill, Quintessence Publishing co. Inc,1997 .</p>												
Hartimi i planit mësimor:													
Java	Titulli i ligjëratisë												
<i>Java 1:</i>	Njohja me gnatologjinë												
<i>Java 2:</i>	Kockat e sistemit orofacial												
<i>Java 3:</i>	Muskujt orofacial												
<i>Java 4:</i>	Artikulacioni temporo-mandibular												
<i>Java 5:</i>	Anatomia funksionale e denticionit natyror												

Java 6:	Raporti ndërmjet vargjeve të dhëmbëve dhe kontakti i dhëmbëve në pozitën e interkuspidimit maksimal
Java 7:	Fiziologjia e okluzionit
Java 8:	Determinantet anatomike të lëvizjes së nofullës së poshtme
Java 9:	Lëvizjet e nofullës së poshtme
Java 10:	Lëvizjet funksionale të nofullës së poshtme
Java 11:	Pozitat referente të nofullës së poshtme
Java 12:	Okluzioni fiziologjik optimal
Java 13:	Okluzioni jofiziologjik
Java 14:	Okludatorët
Java 15:	Artikulatorët
Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes	
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së</i>	

60. IMPLANTOLOGJIA DENTARE


Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë/Dega e Stomatologjisë
Titulli i lëndës:	Implantologjia Dentare
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i IV (katërt) , semestri i VIII (tetë)
Numri i orëve në javë:	1+1+0
Kreditë ECTS:	3.0
Koha / Vendi:	Amfiteatri i QKSUK, sallat e seminareve dhe salla e paraklinikës dhe salla operative në klinikën e Kirurgjisë Orale
Mësimdhënësi:	Prof.Assoc. Dr. Resmije Ademi-Abdyli Prof.Ass.Dr. Zana Agani Prof.Ass.Dr. Jehona Ahmedi
Të dhënat kontaktuese:	resmije.ademi@uni-pr.edu Konsultimet : E premte 11:00 – 12:00 zana.agani@uni-pr.edu jehona.ahmedi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Programi mësimor i lëndës Implantologji dentare që mbahet në vitin e IV (katërt) në semestrin e VIII (tetë) , ju ofron studentëve njohuri të përgjithshme mbi implantologjinë dentare si ; bazat e implantologjisë dentare, llojet dhe materialet e implanteve dentare, planifikimin e vendosjes së implanteve dentare, indikacionet dhe kontraindikacionet për vendosje të implanteve dentare dhe për intervenime kirurgjike plotësues para vendosjes së implanteve dentare (sinus lifting, shtimi i kockës) Poashtu studentët informohen mbi procedurat kirurgjike të vendosjes së implanteve dhe procedurat protetike të vendosjes së suprastrukturës parciale apo totale si edhe komplikimet gjatë dhe pas vendosjes së implanteve dentare.

Qëllimet e lëndës:	Implantologjia dentare ka për qëllim që studentët të arrijnë njohuri të përgjithshme për : punën ekipore të planifikimit të vendosjes së implanteve dentare, indikacionet protetike në implantologjinë dentare, caktimin e indikacioneve dhe kontraindikacioneve kirurgjike për vendosjen e implanteve dentare sipas gjendjes lokale (anatomia) dhe gjendjes së përgjithshme shëndetësore të pacientit, procedurat e tretmanit kirurgjik si ngritja e sinusit dhe shtimi i kockës dhe procedurat kirurgjike të vendosjes së implanteve si dhe fazat e vendosjes së suprastrukturës protetike sipas llojit (kurora individuale, mbështetës të urave apo protezave
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët duhet të edukohen që në përvojën e tyre profesionale të mëvonshme në problematikën e implantologjisë dentare, për zgjidhjen korrekte të problemit të padhëmbësisë parciale apo totale është e domosdoshme qasja interdisciplinare.

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjëratat	1	15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	1	5	5
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/4 (çdo muaj gjatë semestrit)	4
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	10	10
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	20	20
Përgatitja për provimin final	1	20	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1		1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 / 3 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të bëhet me anë të ligjeratave, seminareve, ushtrimeve në modele të procedurave dhe teknikave të ndryshme kirurgjike të vendosjes së implanteve .		
Metodat e vlerësimit:	Provimi final mbahet me shkrim në formë testi me prag të kalueshmërisë prej minimumi 51% të pikëve totale të testit.		

	<p>Metodat e vlerësimit:</p> <p>Vlerësimi i parë: 5% (vlerësimi 1 deri 5 pikë)</p> <p>Seminari 5 % (vlerësimi 1 deri 5 pikë)</p> <p>Vijimi i rregullt 5% (vlerësimi 1 deri 5 pikë)</p> <p><u>Provimi final</u> 85%</p> <p>Gjithsej 100% (100 pikë maksimumi)</p>
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Knezevic, Goran. Osnove dentalne implantologije, Skolska knjiga - Zagreb, 2002 2. Halid Sulejmanagic & Sead Redžepagić, Osnovi Dentalne Implantologije. Sarajevo, 2002 3. Peterson L, Ellis E, Hupp J, Tucker M. Contemporary Oral and Maxillofacial Surgery. 5th Edition, 2008 4. Fragiskos D Fragiskos-Oral Surgery .2007. 5. Ljubomir Todorovic. Oralna Hirurgija. Nauka,2002
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjeratat e mësimdhënësit



Hartimi i planit mësimor teorik për semestrin e VIII (tetë)

Java	Titulli I ligjëratisë që do të zhvillohet
Java 1:	Njohja me planprogramin e lëndës. Historia e implantologjisë dentare
Java 2:	Procesi i oseointegrimit në implantologjinë dentare
Java 3:	Indikacionet për vendosjen e implanteve dentare
Java 4:	Kontraindikacionet lokale dhe të përgjithshme për vendosjen e implanteve dentare - absolute dhe relative
Java 5:	Planifikimi i vendosjes së implanteve dentare dhe selektimi i rasteve bazuar nëRTG 3D - leximi dhe interpretimi i imazhit radiografik 3D
Java 6:	Augmentimi (shtimi) vertikal dhe horizontal i kockës – intervenim kirurgjik plotësues para vendosjes së implanteve dentare
Java 7:	Sinus liftingu - intervenim kirurgjik plotësues para vendosjes së implanteve dentare
Java 8:	Llojet e implanteve dentare – materialet dhe format
Java 9:	Kompleti i instrumenteve për vendosjen e implanteve dentare dhe procedura kirurgjike - njëfazore dhe dy fazore
Java 10:	Komplikimet gjatë procedurës kirurgjike të vendosjes së implanteve dentare
Java 11:	Komplikimet pas vendosjes së implanteve dentare – komplikimet postoperative të hershme
Java 12:	Komplikimet pas vendosjes së implanteve dentare – komplikimet postoperative të vonshme <i>Vlerësimi intermediar</i>
Java 13:	Tretmani protetikor i pacientëve me implante dentare, mjetet dhe suprastrukturat protetikore në implantoogjinë dentare Protetika fiske në implantologjinë dentare - vendosja e suprastrukturës për punime protetike fikse - kurora dhe ura
Java 14:	Protetika mobile në implantologjinë dentare - vendosja e suprastrukturës për punime mobile – proteza mobile
Java 15:	Prognoza e implanteve dentare dhe mirëmbajtja - suksesi dhe dështimi <i>Vlerësimi i vijshmërisë dhe aktivitetit të studentit</i>

1970 MCMLXX

Hartimi i planit mësimor praktik për semestrin e VIII (tetë):

Java	Titulli i ushtrimit që do të zhvillohet
Java 1:	Njohja me planprogramin e lëndës dhe mënyrën e zhvillimit të mësimin dhe vlerësimit të studentëve.
Java 2:	<i>Llojet e implanteve dentare sipas formës dhe materialeve SEMINAR</i>
Java 3:	Diskutim mbi caktimin e indikacioneve për vendosje të implanteve dentare <i>Indikacionet dhe kontraindikacionet lokale për vendosje të implanteve dentare SEMINAR</i>
Java 4:	Diskutim mbi faktorët e përgjithshëm me ndikim në vendosje të implanteve <i>Kontraindikacionet e përgjithshme për vendosjen e implanteve dentare SEMINAR</i>
Java 5:	Demonstrim i planifikimit të vendosjes së implanteve dentare-analiza klinike dhe RTG
Java 6:	Diskutim mbi procedurën kirurgjike parapërgatitore për vendosje të implanteve dentare. <i>Shtimit horizontal dhe vertikal të kockës, llojet dhe procedura -SEMINAR</i>
Java 7:	Procedura kirurgjike parapërgatitore për vendosje të implanteve dentare <i>Ngritja e sinusit (sinus lifting) - indikacionet dhe kontraindikacionet- SEMINAR</i>
Java 8:	<i>Preservimi i alveolës SEMINAR -</i>
Java 9:	Prezentimi i instrumenteve dhe setit për vendosjen e implanteve dentare dhe principet e përdorimit të tyre
Java 10:	Demonstrim i procedurës kirurgjike të vendosjes së implanteve dentare - dyfazore dhe njëfazore
Java 11:	Diskutim mbi komplikimet dhe dështimet gjatë procedurës kirurgjike të vendosjes së implanteve dentare, menaxhimi dhe mënyra e parandalimit të tyre <i>Komplikimet e hershme gjatë procedurës kirurgjike të vendosjes së implanteve dentare SEMINAR</i>
Java 12:	Trajtimi i komplikimeve postoperative të vonshme në implantologjinë dentare dhe menaxhimi i tyre- prezentim i rasteve <i>Komplikimet e vonshme postoperative në implantologjinë dentare SEMINAR</i>
Java 13:	Teknikat e marrjes së masave për trajtimin protetikor i pacientëve me implante dentare Procedura laboratorike protetikore e vendosjes së suprastrukturës - te punimet mobile dhe punimet fikse- demonstrim
Java 14:	<i>Komplikimet e lidhura me punime protetikore SEMINAR</i>
Java 15:	Diskutim mbi mënyrën e mirëmbajtjes së implanteve dentare <i>Faktorët ndikues në prognozën e implanteve dentare SEMINAR</i> <i>Vlerësimi i vijueshmërisë dhe aktivitetit të studentit</i>

61. OTORINOLARINGOLOGJIA

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	UNIVERSITETI I PRISHTINËS -FAKULTETI I MJEKËSISË DEGA: STOMATOLOGJIA
Titulli i lëndës:	OTORINOLARINGOLOGJIA
Niveli:	Bazik
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	4, semestri 8-te
Numri i orëve në javë:	1+2
Kreditë ECTS:	3
Koha / Vendi:	
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Qazim Hysenaj Ass. Dr. Emine Ramku, dr. sc Ass. Arsim Behramaj, mr.sc Katedra e otorinolaringologjisë – Klinika e ORL-së Kontakti gazim.hysenaj@uni-pr.edu Konsultimet te merkureve nga ora 12-13
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	<i>Lënda ne përmbajtje ka për qellim njohjen e studenteve me lenden e ORL-KKQ, patologjinë, diagnostikimin dhe trajtimin e semundjeve te veshit, hundes dhe fytit..</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Zhvillimi i mësimit nga lënda e Otorinolaringologjisë Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës sipas planit dhe programit mësimor të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë;</i> <i>Përgatitja e studentëve për doktor të mjekësisë, për punë praktike dhe njohuri teorike nga lënda e Otorinolaringologjisë Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës</i>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<i>Përgatitja teorike, përgatitja praktike, aftësimi për të punuar vetëm dhe në ekip.</i> <i>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</i> <i>Pas përfundimit të mësimit nga kjo lëndë studenti duhet të jetë në gjendje:</i> <i>Ta kuptojë përmbajtjen e lëndës së Otorinolaringologjisë Kirurgjisë së Kokës dhe Qafës;</i>

	<p><i>Të aftësohet për ekzaminimet në këtë lëmi; Të njoh ndryshimet patologjike;</i></p> <p><i>Të jetë në gjendje që të bëjë diagnostikimin e patologjive të ndryshme nga kjo lëmi;</i></p> <p><i>Të jetë në gjendje që për shumicën e sëmundjeve që kërkojnë trajtim konservativ të acaktojë dhe të përshkruaj terapinë adekuate;</i></p> <p><i>Të dijë, për rastet të cilat kërkojnë metoda të veçanta diagnostike dhe trajtim kirurgjik dhe përkuqdesje specialistike, t'i udhëzojë në qendrat përkatëse.</i></p>
Metodat e mësimdhënies:	<i>Ligjërata, ushtrime, seminare dhe konsultime.</i>
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Vlerësimi gjatë kohës së zhvillimit të mësimin, testi intermediar,</i></p> <p><i>Provimi final: testi, provimi praktik, provimi teorik</i></p>

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Ligjëratat	1	1/15	15
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	2	1/15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	1/5	5
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	1/2	2
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	1/11	11
Përgatitja për provimin final	1	1/10	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1/2	2
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			75 (3 ECTS)

Literatura primare:	<p><i>Limani A, et al: Otorinolaringologjia Kirurgjia e Kokës dhe Qafës.</i></p> <p><i>Ballenger J J, Snow J B.: Ballenger's Otorhinolaryngology Head and Neck Surg</i></p> <p><i>ISBN: 1550091972; Format: HB; Pages: 1600</i> <i>Publication Date: 11 Jan 2002; Edition : 16</i></p>
Literatura shtesë:	<i>Platformat e ORL -së ne internet</i>
Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<p>Ora hyrëse. Otorinolaringologjia-njohurit e përgjithshme. Anatomia dhe fiziologjia e kokës dhe qafës. Fasciet e kokës dhe qafës, Muskujt e kokës dhe qafës, Topografia e kokës dhe qafës, Arteriet dhe venat e kokës dhe qafës. Sistemi nervor i kokës dhe qafës;</p> <p>Praktika: mënyra e marrjes së anamnezës otorinolaringologjike, inspekcioni, palpacioni i kokës dhe qafës; ushtrimi i vendosjes së pasqyrës së ballit, ose kllarit, njohja me pozitën që duhet të ketë ekzaminuesë dhe i ekzaminuari, ushtrimi për fokusimin e dritës me pasqyrën ballore; njohja me vendin e punës së doktorit në ambulancën e kontrollit të pacientëve.</p>
Java 2:	<p>Indi limfatik i kokës dhe qafës, nyjat limfatike, gjëndrat pështymore, anatomia, fiziologjia, patologjia, proceset inflamatorë, tumoret e indeve të buta të kokës dhe</p> <p>qafës, diagnostikimi dhe terapia. Disekcionet e qafës. Gjëndra tiroide dhe paratiroide.</p> <p>Praktika: përcaktimi i niveleve të nyjave limfatike në kokë dhe qafë, inspekcioni i masave neoplazike; mënyra e ekzaminimit fizikal i gjëndrës tiroide dhe gjëndrave pështymore. Dallimi i ndryshimeve patologjike nga gjendjet normale të gjëndrës tiroide, gjëndrave pështymore dhe nyjave limfatike, prezantimi i rasteve.</p>
Java 3:	<p>Hunda. Anatomia dhe fiziologjia e hundës. Metodat diagnostikues e. Deformimet e septumit dhe piramidës së hundës. Inflammacionet e hundës, Riniti alergjik dhe vazomotorë. Polipoza e hundës. Epistaxis, trupat e huaj në hundë, Rinolitet; Ozena; Tumoret e hundës.</p>

	<p>Praktika: rinoskopia e përparme dhe e pasme, dallimi i pamjeve në mukozën e hundës te rastet normale dhe me procese inflamatore, rinoskopia te rastet me hipertrofi të konkave, te rastet me poliozë të hundës. Dallimi i përmbajtjes patologjike nga sekreti fiziologjik. Dallimi i devijimeve të septumit nazal dhe frakturave të hundës në imazherit rentgenologjike. Bërja e tamponadës së përparme të hundës. Bërja dhe leximi i rinomanometrisë.</p>
<i>Java 4:</i>	<p>Hapësirat paranazale (HPN); Anatomia dhe fiziologjia; metodat diagnostikuese; Inflamacionet e sinuseve paranazale; Sinuzitet te fëmijët. Lëndimet e HPN; Fistulat oroantrale; Aerosinusitis; Komplikimet sinusogjene. Tumoret e hundës dhe HPN.</p> <p>Praktikë: karakteristikat anamnestike te rastet me sinusit, leximi i rentgengrafive klasike të sinuseve, i tomografive të kompjuterizuara dhe përshkrimi i karakteristikave imazherike te rastet pa dhe me përmbajtje në hapësirat paranazale. Bërja e tamponadës së pasme të hundës, nxjerrja e trupave të huaj nga hunda.</p>
<i>Java 5:</i>	<p>Anatomia dhe fiziologjia e hapësirës së gojës dhe orofaringut. Tumoret beninje dhe malinje të orofaringu. Malformacionet kongjenitale gojës dhe orofaringut. Manifestimet e sëmundjeve të ndryshme infektive në gojë dhe në orofaring.</p> <p>Praktika: karakteristikat anamnestike për patologjinë e gojës dhe orofaringut, orofaringoskopia; marrja e strishos nga goja, orofaringu dhe hunda; prezantimi i rasteve me malformacione të gojës</p>
<i>Java 6:</i>	<p>Patologjia e tonsillave dhe problemi tonsillar. Tumoret malinje të nazofaringut Patologjia e hipofaringut; Anatomia dhe fiziologjia e ezofagut. Patologjia e Ezofagut, Helmimet me materie korrozive. Lëndimet mekanike të ezofagut, trupat e huaj të ezofagut. Anomalitë e lindura të ezofagut. Tumoret e ezofagut.</p> <p>Praktika: orofaringoskopia, përshkrimi i karakteristikave të bajameve normale, hipertrofike, atrofike; anginat; adenoidet hipertrofike karakteristikat e jashtme (facies adenoidea). Laring-hipofaringoskopia indirekte; laringo-faringoskopia direkte; ezofagoskopia; prezantimi irasteve me trupa të huaj në hipofaring dhe ezofag. Leximi i rentgenpasazhave të ezofagut.</p>
<i>Java 7:</i>	<p>Anatomia e veshit, Veshi i jashtëm (lapra e veshit, kanali i jashtëm auditiv). Veshi 5 mesëm (membrana timpani, zgavra timpani, kockat</p>

	<p>auditive, procesi mastoid dhe tuba e Eustakit). Veshi i brendshëm (labirinti kockor- vestibullumi, koklea dhe kanalet gjysmë rrethore kockore, labirinti membranoz- utrikuli, sakuli, duktuset gjysmë rrethore, ampullat e kanaleve gjysmë rrethore dhe duktusi koklear, organi spiral i Cort-it). Vaskularizimi dhe nervëzimi i veshit.</p> <p>Praktika: inspekcioni i veshit të jashtëm, otoskopia, dukja normale e kanalit të jashtëm të dëgjimit, pamja normale e cipës së veshit, umbo membrane timpani, stria mallearis, trigonum lucidum, cerumeni.</p>
<i>Java 8:</i>	<p>Fiziologjia e dëgjimit dhe aparatit vestibular. Elementet themelore të dëgjimit. Diagnostikimi (përcaktimi) i dëgjimit, provat akumetrike, audiometria tonale, audiometria folijore, audiometria sipas Bekesy. Audiometria objektive</p> <p>Ekazminimi i traktit vestibulo-spinal dhe vestibulo-okulomotor. Elektronistagmografia dhe testet për ekzaminimin e sistemit të drejtpeshimit.</p> <p>Dëmtimet e dëgjimit prenatal, perinatal dhe postnatal. Dëmtimet toksike të veshit të brendshëm dhe herpes Zoster otikus.</p> <p>Aparatet ndihmëse të dëgjimit –amplifikatore.</p> <p>Praktika: ushtrimi i përdorimit të diapazoneve akustike, bërja e provave akumetrike (testi i përcjelljes ajrore, Weber, Rhine, Schwabach), ushtrimi i përdorjes së eudiometrit dhe bërjes së audiogramave. Bërja në praktikë e testit kalorik, njohja praktike e ekzaminimit me elektronistagmografi</p>
<i>Java 9:</i>	<p>Patologjia e veshit të jashtëm. Proceset inflamatore, anomalit e lindura, tumoret e veshit të jashtëm.</p> <p>Anatomia dhe fiziologjia e nervit facial.</p> <p>Paralizat periferike dhe qendrore të nervit facial. Diagnostikimi, klinika dhe trajtimi.</p> <p>Praktika: prezantimi i pacientëve me cerumen obturans, me otit ekstern, marrja e anamnezës, palpimi me qëllim të diagnostikimit, dallimi i otitit ekstern difuz nga mastoiditi. Shpërlarja e kanalit të jashtëm të dëgjimit me qëllim të mënjanimin të cerumenit dhe trupave të huaj. Incizioni i furunkuleve në veshin e jashtëm.</p>
<i>Java 10:</i>	<p>Patologjia e veshit të mesëm. Çrregullimet funksionale të tubës së Eustach-it. Proceset inflamatore (otitis media secretoria, otitet akute dhe kronike), lëndimet (ruptura e membranës timpani, frakturat e kockës</p>

	<p>temporale). Komplikacionet otogjene ekzo dhe endokraniale. Otoskleroza. Timpanoskleroza.</p> <p>Operacionet e veshit te mesem, paracenteza (miryngotomia), tympanoplastika, antrotomia, mastoidektomia dhe trepanacioni radikal i kockës mastoidale.</p> <p>Implanti koklear, njohurit e përgjithshme.</p> <p>Praktika: Otoskopia (dallimi i perforacioneve); karakteristikat e provave akumetrike dhe audiometrike te otitet; timpanometria; leximi i radiografisë sipas Schuller-it.</p>
<i>Java 11:</i>	<p>Patologjia e veshit të brendshëm. Syndromat kongjenitale; Proceset inflamatore, labirintitet, neuronitis nervi vestibulares.</p> <p>Shurdhimet akute, kinetoza, traumat akute dhe kronike akustike, Prezbiakuza. Morbus Menier. Tumoret e veshit te brendshëm, neurinoma e nervit statoakustik.</p> <p>Praktika: leximi i audiogrameve tonale, bërja e testit kalorik dhe të tjera për vlerësimin e sistemit vestibular, testet supraliminare. Përcaktimi i nistagmusit, leximi i elektronistagmorameve, Ekzaminimet neurologjike</p>
<i>Java 12:</i>	<p>Laringu. Anatomia dhe fiziologjia e laringut. Ekzaminimet e laringut, inflamacionet akute dhe kronike të laringut. Laringjiti difterik, laringjiti subglotik dhe laringo-tracheobronchitis acuta suffocans. Perichondriti i laringut, abscesi i laringut. Ilamacionet specifike të laringut. Lëndimet e laringut.</p> <p>Praktika: laringoskopia indirekte, laringoskopia direkte, përshkrimi i pamjes normale dhe pamjeve karakteristike te proceset inflamatore. Përshkrimi i ngjyrës te rastet inflamatore akute dhe kronika. Karakteristikat e edemave të kordave vokale</p>
